

BIBLIOTEKA

8SH-31
M33-

PETRO
MARKO



SHIPËLLA
E
PIRATEVE
ROMAN

SSH-31
M 33

PETRO MARKO

SHPELLA E PIRATËVE

SHTËPIA BOTUESE "MËSONJËTORJA"
TIRANË, 1998

Përpunimi në kompiuter: K.Bajraktari
Korrektore letrare: V. Xhixha

I dashuri Besnik

Të kujtohet shëtija që bëmë me motoskaf nga Jaliskari në Jali e në Spilë të Himarës ?

Ti ishe i hutuar nga bregdeti i çuditshëm, shikoje shpellat e shumta e sidomos peshqit fluturues, që nuk kishe parë kurrë ndonjëherë, dhe mahnitëshe. Te kepi ku dolën qindra zogj - deti, si dallëndyshe të mëdha, me krahë ngjyrë deti të thellë, ti ia ngule sytë një shpelle të çuditshme dhe më pyete: "Po ajo ç' është?", dhe unë të thashë: " Është Shpella e Piratëve!".

Pastaj nuk më pyete më, se ishe i dehur nga panorama mahnitëse Maleve të Vetëtimës, nga fshatrat e bukur të cilët që nga deti ku ishim ne dukeshin si kështjella.

Unë vazhdova të thosha: "A e di pse fshatrat e Himarës janë larg nga bregu dhe pse janë ndërtuar qëmoti si kështjella? se vinin piratët ...". Po ti, pa ua vënë veshin shpjegimeve të mia, thirre edhe i trëmbur edhe kureshtar.

- Po ai njeri atje?

U ktheva të shikoja. Jo shumë larg Shpellës së Piratëve shquhej një kokë njeriu. Nuk lëvizte fare. Ishte bërë një me shkëmbinjtë e nxirë. Ku të shkuan

sytë atje, more Besnik! Paske pasur sy të fortë! Unë, egjithëse s' kam lënë shkëmb e shpellë pa shkelur, atje kurrë nuk kisha zbritur ndonjëherë. Dhe jo vetëm unë po as edhe ndonjë tjetër përveç Niko Dabos. Dhe thashë atëherë me vete: "Niko Daboja do të jetë! Po pse ka zbritur atje, në atë vend ku nuk zbret asnjëri, përveç zogjve, ose atyre që venë me varkë?"

Pastaj ne lundruam larg dhe pamë gjithë ngjyrat e bregut të detit, pamë më shumë zogj deti, pamë edhe një delfin, që kridhej në thellësi e dilte përsëri mbi ujë... Ti vazhdoje të më pyesje, por unë nuk të përgjigjesha, se vrisja mendjen e thoshja: "Pse Niko Daboja, plak, ka zbritur në atë vend?"

Pasi ike ti bashkë me prindërit e tu në Vlorë, unë vendosa ta zgjidhja këtë pikëpyetje që më lindi në kokë.

Në fillim më nxiti vetëm kureshtja që të mësoja pse kishte zbritur Niko Daboja në atë vend të çuditshëm, por pastaj dolën edhe gjëra të tjera dhe puna mbaroi me një ekspeditë fantastike, të cilën dëshiroj ta mësosh edhe ti, se këtu janë habitur të gjithë fshatrat e Himarës dhe flasin për këtë ekspeditë, flasin për mua dhe për katër shokët e mi që u bëmë heronjtë e kësaj ndërmarrjeje të guximshme si për një gjë, që ka rëndësi të madhe.

Puna ndodhi kështu:

1. Tregimi i Niko Dabos

Ne e dinim që Niko Daboja ishte peshkatar i mirë i fshatit; e dinim që Niko Daboja ishte notari më i fuqishëm i fshatit. Madje disa thoshin se ishte notari më i patrembur i botës. E kishim parë disa herë të ecte me shpinën drejt, ndonëse ishte plak. Nuk shikonte mirë. Thuhej se i kishte sytë si të peshkut dhe vetëm në ujë shikonte edhe vrimën e gjilpërës. Po, kështu thoshin: Një herë iu shpua trasta me të cilën zinte peshqit, aty në thellësitë e detit, dhe ai nxori gjilpërën, i shkoi perin dhe qepi trastën.

Kishim dëgjuar shumë heroizma të Niko Dabos; kishim dëgjuar se ai kishte notuar tridhjetë orë rresht. Po heroizmi më i madh i tij kishte qënë mundja me peshkaqenin.

Tani si të bëja unë për të ruajtur Niko Dabon e për të parë se si zbriste deri te shkëmbi pranë Shpellës së Piratëve? Mendova gjithë natën. Në mëngjes herët shkova e fola me shokët e mi, Janin dhe Foton. Jani është një shok trim. Atë e kemi edhe komandant të çetës; kurse Fotoja nuk është shumë -

shumë trim, por është shumë i mençur.

Ata më dëgjuan kur u fola mbi planet e mia, pastaj Jani më pyeti:

- E pe mirë? Niko Daboja ishte, apo të bënë sytë?

Po Fotoja, që po mendohej, na e ndërpreu bisedën dhe thirri i gëzuar:

- E gjeta!

- Çfarë gjete? - e pyeti Jani.

- E gjeta! Iliri tha që Jani të jetë komandant dhe unë komisar politik... Jo! Ne tre veta jemi gjithsej. Prandaj unë mendoj të vemi e të gjejmë Lolon. Ai është më i madh se ne dhe më trimi i të gjithë pionierëve. Ai të jetë kapedani ynë!

Mendimi i Fatosit na pëlqeu. Që të tre shkuan te Shpella e Pano Gjinit. Aty rrinte Loloja.

Kishte ndërtuar një dylbi të madhe me disa qelqe të trasha dhe shikonte gjemitë, që kalonin tej në hapësirën e detit.

Me mundime të mëdha hipëm në Shpellën e Pano Gjinit, dhe Lolon e gjetëm atje duke lexuar.

- Ç' kërkon këtu? - na foli me inat pa lëvizur fare nga shtrati me gjethe mani, që e kishte bërë vetë e ku ishte shtrirë atë kohë.

- Kemi një punë me ty! - i foli Fotoja, që ishte më i mençur se ne.

- Jini zënë me lagjen Gjinlek? - na pyeti si i mërzhitur që i prishëm qetësinë.

- Jo! - i thashë unë.

- Po ç' ka ndodhur?

- Kemi një plan,... - i folëm ne mengadalë, se mos na dëgjonte kush.

- Flisni më fort, se këtu nuk na dëgjon njeri.

Jani e ngriti zërin. Loloja, pasi na dëgjoi, qeshi. Plani i pëlqeu shumë dhe pranoi të ishte kapedani ynë.

Unë u ula pranë dylbisë së madhe. Ishte e gjatë dy metra dhe kishte një mbështetje me tri këmbë. E drejtova mirë, mbylla njërin sy dhe me syrin tjetër po shikoja bregdetin. Eh, sa qartë dukeshin zalli dhe shkuma e bardhë e dallgëve!

- Dale të shikojmë kepin e Shpellës së Piratëve! - më tha Loloja dhe e mori vetë dylbinë e gjatë. - Ja ku është shpella... Si ka zbritur deri atje Niko Daboja? S' është e mundur të ketë zbritur nga lart. Ai s' ka krahë... Patjetër që do të ketë shkuar atje me ndonjë varkë...

- Ose me not! - ja preu Fotoja i mënçur.

- Me not jo! - thashë unë, - se ku u zhvesh e nga u nis?

- As me varkë jo! - shtoi Jani.

- Po atëhere si do të ketë zbritur deri atje?! - pyeti Loloja pa u larguar nga dylbia e madhe.

E vështroja Lolon dhe më dukej si një kapedan vapori. Me atë trupin e gjatë e të drejtë, me ata flokët e zinj dhe kaçurrela, me atë fytyrë të nxirë nga dielli dhe me ato buzë të trasha ai i ngjante tamam një komandanti piratësh. Ishte vetëm me të mbathura dhe gjoksín e kishte të gjerë e gjithë muskuj.

Si e la dylbinë, Loloja u kthye nga ne, na hodhi një shikim pakëz si të egër dhe na foli:

- Unë pranoj të jemë kapedani juaj, por vetëm me një kusht.

Dhe heshti. Shkoi pakëz më tutje dhe nga një vrimë nxorri një thikë. Na u afrua. Zgjati thikën horizontalisht, vuri dorën në majën e saj të mprehtë dhe na ftoi të vinim dhe ne dorën në majën e saj të mprehtë. Dhe ne ashtu bëmë. Katër duar të shtrira mbi majën e thikës së mprehtë!

- Tani, shokë, ne do të betohemi! - tha Loloja me fytyrë të vrenjtur.

Unë e ndjeva veten krenar, se kurrë nuk kisha bërë një betim të tillë. Mu drodh pakëz dora mbi majën e thikës së mprehtë.

- Pra, ju do të përsërisni fjalët e betimit! - foli me zë burrëror Loloja. Dhe vazhdoi:

- **Betohem!**

- **Betohem!** - përsëritëm ne të tre.

- **Se do të jem besnik i shokëve të mi deri**

në vdekje! - tha Loloja...

- Se do të jem besnik i shokëve të mi deri në vdekje! - thamë ne.

Edhe oshëtima e Shpellës së Madhe të Pano Gjinit përsëriti me zë të trashë: **“ Se do të jem besnik i shokëve të mi deri në vdekje”.**

- Dhe do ti bindem urdhërit të kapedanit!
- vazhdoi Loloja!

Dhe ne përsëritëm: **“Dhe do ti bindem urdhërit të kapedanit!”**

- Dhe po të frikësohem e po të tradhtoj nuk do të kemë të drejtë të shoqërohem më me shokët dhe me ndonjë pioner..

Ne pamë Foton. Po dhe Fotoja i përsëriti këto fjalë me zë të lartë.

Loloja na shtrëngoi dorën. Na dha dhe dy karrube¹ të gjata dhe dha urdhërin e parë:

- Nesër do të zgjoheni në orën tre.... Në atë orë kur venë fshatarët në mal për sherbelë... Do të merrni të gjithë nga një thikë, nga një kuti shkrepse, bukë dhe nga një litar... Më dëgjuat?

- Si urdhëron! - u përgjegjëm ne.

- Po ku do ta gjejmë litarin? - pyeti Fotoja.

- Nga ata të samarëve të gomerëve, ose ndonjë tërkuzë nga ato me të cilat ngarkoheshin deri dje nënat tona! - tha Loloja duke tundur thikën e

mprehtë.

U ndamë. Nuk folëm më. Kur zbritëm nga shpella e Pano Gjinit, më priste Lulja, motra ime.

- Ku ke qenë? - më pyeti ajo.

- Isha deri te xha Stefoja.

- Çfarë xha Stefo! Ti zbritë nga shpella e Pano

Gjinit!

- Ti nuk shikoke mirë!

- Ti nuk thua të vërtetën!

- Pa shiko punën tënde ti!

- Unë të kam kërkuar se do të shkonim te Burimet... Atje do të kalojmë gjithë ditën... Atje ku Miloja ka ndërtuar vetë një hidrocentral të vogël me një llampë, që qëndron ditë e natë e ndezur...

Motra nuk më ndahej kurrë. Ajo dëshironte të shëtiste me mua, se ishte dy vjeç më e vogël se unë. Si do t' ia bëja tani që të mos më ngjitej?

Aty për aty trillova ca takime, që gjoja kisha me shokët e mi. Dhe pas shumë mundimesh e binda.

Unë duhej të gjeja tani një thikë të mpehtë dhe një litar. M'u kujtua gomari i Mama Tullës, prandaj shkova andej. Në oborr pashë samarin dhe litarin e mbledhur në kaptell. U gëzova. Litarin e sigurova. Po thikën! Më dukej se Mama Liloja kishte një thikë të gjatë e të mprehtë. Kur shkova në shtëpi të saj, ajo po qëronte farën e qepës. Mama Liloja u gëzua shumë

kur më pa. Po edhe unë u gëzova shumë kur pashë thikën e bukur.

E pyeta a mund të ma jipte deri të nesërmen.

- Merre, mor bir i nënës! Po ç' të hyn në punë thika?

- Do vete për kallama, - i thashë unë, - dhe dua të bëj një xamare te bukur...

Kur erdhi mbrëmja dhe të gjithë u mblodhën në shtëpi, unë shkova edhe një herë në kopsht për të parë litarin dhe thikën, që kisha fshehur nën gjethet e një rrënje kungulli. Në të dalë nga kopshti, vura re se Lulja po përkëdhelte Bardhishkën, dhinë tonë malteze; ajo i hodhi një herë sytë nga unë, po nuk më vuri re fare.

Nuk e mbaj mend në më zuri gjumi apo jo. Po më bëhej sikur dëgjoja një melodi të ëmbël të shoqëruar me zile, me këmborë e me mijëra xamare dhe dyjare. Hapa sytë. Kjo melodi e ëmbël na qënkish kënga e të rinjve e të rejave. Ata ishin zgjuar në mes të natës. Do të shkonin në mal për sherbelë. Dhe kënga e tyre e bukur, që oshëtinte atje lart, ftonte të tjerët që ende flinin. Po ja që më zgjoi edhe mua. Zgjoi gjithë fshatin.

U ngrita. U veshja me shumë kujdes, mora trastën me bukë, kutinë e shkrepseve dhe dola jashtë, u futa në kopsht, mora thikën e litarin dhe nuk dola

nga dera e oborrit po u hodha nga muri dhe mora rrugën e kepit të Shpellës së Piratëve.

Kënga e të rinjve po oshëtinte më shumë. Sa përshtypje të madhe më bëri!

Kur u gjenda në rrugën e madhe, vura re se s' kishte njeri. Nën ullinj loznin hijet e thella, kurse në pllajat e zhvëshura kish nisur të shquhej drita e agimit.

S' kisha parë kurrë një agim të tillë. Në qiell yjet po humbisnin e shkriheshin si kokrrat e sheqerit në ujin e kaltërt. Nën mua deti i qetë flinte i madhërishëm. Ç' qetësi dhe bukuri e rrallë! Atje lart Malet e Vetëtimës, si kështjellë shekullore, ngriheshin hierëndë; kurse plazhi përposh si një top basme e bardhë e hapur tej e tej, që nga kampi i Pushimit të Punëtorëve e deri te kepi i Shpellës së Piratëve, nanurisej lehtë nga përshpëritjet e fjetura të valëve të lodhura...

- Sa mirë që u zgjova në kohë! - thashë me vete. - Po ku do të jenë të tjerët? Unë duhet t' i pres në bregun përmbi Spilë.

Era e fresikët dhe ngjyra, që kish marrë gjithë vendi më kishin dehur. Më dukej vetja si në ëndërr...

Kur arrita përmbi bregun e caktuar gjeta shokët. Më prisnin. Nuk më folën. As unë nuk u fola. U ula. Që të katër heshtnim. Shikonim lart majat e maleve se si nisën të ndaheshin nga qielli më i qartë,

kurse malet ishin më të errëta.

- Herën e parë do të duken nisë, - na tha Loloja, - se atje bie pa pengesa agimi. Kurse këtej rrezet e agimit i pengojnë malet e larta.

Ai fliste si një kapedan i vërtetë. Dukej se nuk ishte hera e parë që shikonte agimin. U ngrit e na kontrolloi thikat, litarët dhe kutitë e shkrepseve.

- Në rregull! - tha.

Hodhi sytë përpësh, atje ku dallgët e fjetura loznin brenda guvave të thepisura. Edhe unë iu afrova buzës së shkëmbit të mprehtë thikë. Për pak m' u morën mentë. Menjëherë m' u kujtua Niko Daboja! Si kishte zbritur deri atje poshtë! Edhe gurin po ta hidhje që nga buza ku ishim ne patjetër që do të thërrmohej me të rënë në det!

Loloja më hodhi dorën në sup e më pyeti:

- Atje e pe Niko Dabën?

- Po, ja, atje, pas atij shkëmbit.

- I fortë është qerratai! Sado që është plakur shumë...

Jani nuk fliste fare, kurse Fotoja kishte zgjatur kokën me fytyrën drejt detit dhe mbahej fort me të dyja duart.

- Tani, - urdhëroi Loloja, - ne do të ndahemi. Ti, Foto, do të qëndrosh këtu. Ti, Jani, do të qëndrosh në hyrjen e pyllit. Ti, Ilir, do të qëndrosh te shtegu, më

poshtë hyrjes së pyllit; kurse unë e di vetë se ku do të qëndroj. Do të jem kudo... Sytë katër, ë? Ai që do ta shikojë Niko Dabën duhet ta ndjekë me shumë kujdes, pa u vënë re prej tij.

Pasi na ndau detyrat, përfundoi:

- Kur të dëgjoni një fishkëllimë të gjatë, duhet të mblidheni te prita e Ilirit; kur të dëgjoni dy fishkëllima të gjata, do të mblidheni te prita e Janit; kur të dëgjoni tri fishkëllima të gjata, do të mblidhemi këtu, ku do të qëndrojë Fotoja.

Dhe u ndamë. Unë zura një vend të fshehtë pranë shtegut. U mbështolla me fier të gjatë. Nxora thikën dhe e shikoja. Në ato çaste nuk mendoja për asgjë. Isha krenar që gjithë këtë lojë e krijova unë. Se unë e kisha parë i pari Niko Dabon... Apo e pa Besniku? Ah, të ishte edhe ai këtu! Po Lulja pse më shikonte ashtu? Ajo kishte frikë... Po Niko Daboja nga do të vinte? Po sikur të vinte me not! Po të vinte me not, i pari do ta shikojë Fotoja, që andej lart.

Te isha duke menduar këto, dëgjova një zhurmë. U drodha! Ngrita veshët dhe mbajta frymën. Zemra më rrihte me të madhe. Dëgjova fëshfërimën e barit të thatë. Dikush ecte nëpër barë! Mos është ndonjë gjarpër i madh?! thashë me vete. Mos është ndonjë ujk, ndonjë baldosë, ndonjë çakall, ndonjë dhel për, ndonjë kunadhe? Apo ndonjë lepur!...

Kur ja, koka e Niko Dabos!

Përsëri zemra më rrahu më me shpejtësi, dhe për pak thirra: "Po vjen"! Por urdhëri është urdhër. Duhej heshtur dhe ndjekur me shumë fshehtësi, pa u ndierë, se ç' rrugë do të shkelte peshkatari i famshëm.

E pashë mirë. Ai ishte. Ecte aq lehtë, sa dukej sikur nuk shkelte fare mbi tokë. Kishte hedhur mbi shpinë një trastë të vjetër. Kasketën e kishte të vogël. I qëndronte në majë të kokës. Ndenji ca. Ktheu kokën pas. Shikoi mirë. Pastaj u kthye nga një përrua i vogël që humbiste në pyll. Unë kisha urdhër të vëzhgoja zonën ku fillonte pylli. Më tej ishte zona ku vrojtonte Jani. E vura re mirë vrimën e gjelbër ku u fut Niko Daboja barkas...

Një gëzim i madh më pushtoi, dhe desha të vrapoja e të lajmëroja kapedanin. Po urdhëri është urdhër!

Prita e prita me ankth fishkëllimën. Ajo po vononte! Pse? Ç' do të kishte ngjarë? Ku u füt ashtu peshkatari dhe notari më i fuqishëm i botës? Atje ku u fut ai nuk ishte det, por pyll. Ah, sa dëshiroja të vrapoja e të lajmëroja kapedanin tonë! Po urdhëri është urdhër...

- Ilir, ç' bën aty?

- Ky zë më trembi. Ç' zë ishte ky! Apo më bënë veshët?

- Ilir, unë të pashë! Ç' bën aty?

Në qoftë se u hutova dhe u trondita një herë kur pashë peshkatarin të zvarrisej e të futej në pyll, u hutova dhe u trondita njëqind herë kur pashë përpara meje Lulen, motrën time!

- Ç' bën këtu? Unë të kam ndjekur këmba - këmbës... Dhe i kam dëgjuar planet tuaja.

U ngrita në këmbë i egërsuar dhe i thirra..

- Që tani kthehu në shtëpi! Dëgjon? Tani!...

Ajo zuri të qeshte. Në atë çast dëgjova tri fishkëllima të gjata. Duhej të shkoja menjëherë... Po Lulja?

- Kthehu shpejt në shtëpi, dëgjon?

- Unë i di të gjitha... Dua të vi dhe unë me ju. Sytë e saj të mëdhenj e të kaltërt, sa vinin e zmadhoheshin më shumë.

- Mos më ndiq më pas, kupton?

Ajo qeshi. Pastaj u egërsua. Nuk më foli më. Uli kokën. E lashë ashtu dhe ika, se kishte fishkëllyer tri herë kapedani! Kur arrita buzë shkëmbit, atje gjeta edhe tre shokët e mi. Shikonin përposht peshkatarin e famshëm. Edhe unë zgjata kokën. Po nga kish dalë këtu poshtë Niko Dabo?!

- Kapedani ynë na foli:

- Tani e pamë se nga u fut dhe nga kaloi. O burra, të dalim edhe ne atje poshtë si ai...

Kapedani ynë përpara dhe ne pas. Arritëm te vendi buzë pyllit, nga ku pashë të zvarritej peshkatarit. Loloja u shtri barkas dhe po zvarritej. Ashtu bëmë edhe ne. Pas meje vinte Fotoja. Unë pothua se hiqesha nga këmbët e Janit. Zvarrisu e zvarrisu, arritëm te një tunel i ngushtë dhe i errët.

Kapedani ndezi elektrikun e dorës për të na pirë e për të na ndriçuar. Ishim bërë një varg zvarritës. Asnjë nuk fliste. Ku shkonim ashtu? Ku na shpinte kapedani i ynë?

Zvarrisu e zvarrisu në një shpellë të ngushtë dhe gropa - gropa, dolëm poshtë, buzë detit.

Kur pamë dritën e detin, erdhëm në vete. Fotoja fërkonte duart nga gëzimi. Po kur pamë aty pranë Niko Dabon, morëm më shumë guxim. Me këmbë e me duar, kaluam disa shkëmbinj të thepisur dhe qëndruam në një vend të fshehtë, nga vërenim lëvizjet e peshkatarit plak tetëdhjetë vjeçar pa na diktuar ai.

E pamë që nisi të zinte karkalecë deti; e pamë të hidhte grepin; e pamë që zuri një koce; e pamë që kocen e futi në një apotone¹ të madhe dhe e lidhi mirë me një tel të hollë; e pamë të zhvishej, të merrte në një dorë apotonenë dhe të lidhte fundin e litarit në një shkëmb; e pamë që u hodh nga shkëmbi në det, me një thikë të varur në llërën e mëngjër. Notonte me

ngadalë si një delfin i lodhur. U largua e u largua
aq sa u tendos litari. Atje duket se e lëshoi grepin e
madh. Pastaj qëllonte ujët e detit me këmbë.

- E dini pse e qëllon ujët me këmbë? - tha
kapedani ynë. - Se ashtu dëgjojnë peshkaqenët e
kujtojnë se zihen sinagridhet, pa vijnë me vrap për të
gjetur gjah të mirë....

Peshkatari u krodh nën ujë. Dhe ne nuk e
pamë më. Prit e prit të dilte mbi ujë, nuk u pa gjëkund...
Kur ç' të shihnim? Ai kishte hipur mbi shkëmb, andej
nga ish hedhur!

Ne vështruam njëri - tjetrin në sy!

Niko Daboja filloi të hante uriqe deti që i nxirrte
nga trasta e mbushur.

Unë u habita dhe thashë me vete: "Kur i nxori
gjithë këta uriqe - deti!" U hiqte kokën - kërthizë me
majën e thikës, pastaj i fuste në gojë...

Pasi i hëngri të gjitha, u ul më poshtë dhe
mblodhi goca deti. Edhe ato i hëngri të gjitha.

Pastaj, duke mbajtur litarin në dorë, u shtri
mbi shkëmbin e thepisur.

Kapedani ynë na bëri me shenjë të prisnim.

Dhe ne pritëm. Pritëm. Valët e detit filluan të
bëheshin më të fuqishme. Nga e djathta jonë, kampistët
nisën të laheshin. Sa të vegjël dukeshin! Si mizat e
dheut. Tutje, në fund të horizontit, një vapor llamburiste

si një copëz argjendi mbi ujë.

- Të zura! - thirri peshkatarin, dhe u ngrit përgjysmë e filloi të tërhiqte litarin.

Edhe ne për pak sa bërtitëm *“e zuri!”* po kapedani ynë na mbajti e na bëri me shenjë të mos bënim as gëk.

Me ankth shikonim peshkatarin, që tërhiqte me të shpejtë litarin.

- Ç’ do të ketë zënë vallë? - mendoja unë. - Mos ka zënë ndonjë peshkaqen, apo ndonjë delfin?

Kur ja: pamë një goxha sinagridhe të shndëriste si argjendi!

Loloja nuk duroi. U lëshua drejt peshkatarit. Edhe ne vrapuam pas tij. Peshkatarin e kishte shtrirë sinagridhën e madhe dhe i binte me majën e thikës në bisht. Luante me të. Ajo hidhej dhe kërcente me fuqi. Ai luante dhe luante me të, pastaj i futi një thikë mu në kafkë. Sinagridha e madhe tundi disa herë bishtin dhe pastaj nuk lëvizti më.

- Qënke e bukur! Ku ishe sot? Mos më prisje mua? Unë ndaj erdha që pa gdhirë. Me kishte marrë malli për ty, moj bukuroshe...

E ngriti lart:

- Po, je nja pesëmbëdhjetë kile! Dhe mishin ma ke si të thëllëzës... Se ti je thëllëza e detit....

E përkëdheli. E ktheu në anën tjetër.

- Nuk më prisje, ë? Po nuk e di ti, moj bukuroshe, se unë ashtu rroj? Ja, ti je pesëmbëdhjetë kile. Do të të shes njëqind e pesëdhjetë lekë...

Kur ktheu kokën nga ne, fërkoj sytë mirë. Na u afrua me pranë. U habit. Tundi kokën. U inatos, pastaj qeshi:

- Nga erdhët kështu, mor djema?

- Mos u zemëro! - i tha kapedani ynë.

- Me varkë erdhët?

- Jo!

- Si?

- Jo! - pësëriti Loloja.

Niko Daboja na erdhi fare pranë e na preku me dorë.

- Nuk më besohet! Po si erdhët deri këtu?

Loloja nuk foli.

- Po sa jeni kështu!

- Katër! - tha Loloja.

- Si katër, ju jeni pesë.

- Jo, katër!

- Jeni pesë, mor bir! Ja: një (dhe tregoi Lolon), dy! (dhe tregoi Janin), tre! (dhe më tregoi mua), katër! (dhe tregoi Foton), pesë! (dhe ngriti gishtin duke e drejtuar pas nesh). Që të katërt ne kthyem kokat në drejtim të gishtit të tij, sikur të ishim të urdhëruar prej një suste. E ç' të shikonim? Lulja po buzëqeshte! Unë

desh u ktheva që ta qortoja, por Loloja më mbajti nga krahu. Si mundi të kalonte shpellën - kanal në errësirë?

- Qenka vajzë! - qeshi me të madhe Niko Daboja. - Qenka vajzë! Dhe është vajza e parë, që zbret deri këtu. Për këtë unë do t' i fal sinagridhën... Eja këtu, moj bijë!

Lulja, pa më vënë re mua që isha bërë spec i kuq iu afrua Niko Dabos. Ky i hodhi dorën në kokë. Lulja u turpërua, por edhe një shprehje krenarie e mbuloi fytyrën e saj. Uli kokën dhe kafshoi gishtin tregues të dorës së djathtë.

- Qënke trime. Si të quajnë?

- Lule!

- Lule je ti në këta shkëmbinj. Lule trime dhe e bukur! Unë do të të fal sinagridhën. E meriton...

Të gjithë u mblodhën rreth sinagridhës. Trupi i Niko Dabos dukej si trupi i një delfini plak. Tetëdhjetë vjeç ishte, por gjoksin e kishte të bëshëm e tërë muskuj. Duart i kishte të forta. Dhe këmbët të holla. Në dorën e djathtë i varej një thikë e hollë prej argjendi. Në mes kishte një brez meshini me çengela të vegjël të bardhë. Dukej se atje varte qeset e vogla me gjëra, që i nevojiteshin nën ujë.

- Po ti shikoke fare mirë! - i tha Loloja.

Niko Daboja kishte dy sy si të peshkut, pa

kokordhokë në mes. Ngjyrën e kishin si deti në stuhi.

- Po, mor bir! Unë shikoj mirë sapo kridhem në det. Kur jam larg detit nuk shoh fare.

U ul dhe na hodhi të gjithve një shikim me radhë. Qeshi si peshku. Kishte dhëmbë të vegjël e të dëndur. Qeshi përsëri. Edhe ne qeshëm.

- Qënkeni trima! Po pa më thoni të vërtetën, si erdhët dhe pse erdhët deri këtu?

Loloja i tregoi të vërtetën. I tha se kishim dëshirë të madhe ta shikonim në det e të na tregonte heroizmat e tij.

Peshkatarin plak qeshi përsëri.

- Paskeni zbuluar shtegun e shpellës së fshehtë, ë? E dini ju që atë shteg nuk e di njeri përveç meje? Shtatëdhjetë vjet më parë ma tregoi i ndjeri plaku im... Edhe ai ishte peshkatar... Por në një ndeshje me peshkaqenin u mund... Isha i vogël atëherë. Dhe kur e pashë të përleshej me atë bishë të egër të detit, nisa të ulërija. Por ai më bërtiti: "Mos qaj! Merrma hakun".

2. Përleshja me peshkaqenin

"Unë kurrë nuk e kisha harruar copëtimin e tim eti nga peshkaqeni. Mbase thirrja për hakmarrje ishte dhe shkaku që u lidha më shumë me këtë vend.

Peshkatari plak tregonte dhe ne, të ulur rreth tij e dëgjonim

“Thuhet se një stërgnjyshi im doli nga barku i peshkut!

Kur tha këto, ne u habitëm. Dhe ai na pa. Qeshi dhe vazhdoi:

“Edhe ai na paskej qënë peshkatar. Po një ditë e rrufiti një peshk i madh. E gëlltiti në bark pa e përtypur fare. Dhe peshku i madh, i shpejtë si rrufe, u fut në thellësitë e detit. Po stërgjyshi, që kishte thikë me vete, duke qënë në barkun e peshkut, e mori atë në dorë dhe nisi t’i copëtojë plëndësin, i griu zorrë e mushkëri e zemër, sa peshku ngordhi dhe uji e nxori në sipërfaqe. Stërgjyshi e kuptoi; prandaj me thikë, hapi një vrimë në trupin e trashë të peshkut dhe pa qiellin. Mori frymë lirisht. Vrimën e zmadhoi; e bëri dritare dhe derë. Dhe doli përjashta. Hipur mbi peshkun e madh, sa një varkë, lundroi sa doli në këto anë, ku u bë banor i përhershëm... Ndaj e kemi në gjak peshkimin. Prandaj dhe unë nuk rroj dot pa u kredhur përditë në det, dimër e verë. Të më japin ç’të duan e të më thonë “largohu nga deti”, kurrë nuk e pranoj. Unë vdes pa det... Dhe kur të vdes, e kam

lënë porosi që të më hedhin në det...”

Ai fliste dhe unë vija re se gishtërinjtë e dorës së djathtë i kishte të përkulur si grepa.

- Pse i mban ashtu gishtërinjtë? - e pyeta.

- Kanë një histori... Dikur, në kohën e mbretit, mua më ndiqnin xhandarët e s' më linin të peshkoja. Më ranë në qafë. Një ditë më rrethuan. Unë u hodha dy dinamitë e vrava tre... Më kërkonin që të më varnin. Unë lidha teshat në kokë dhe vendosa të arratisesha, të shkoja në dhe të huaj. Qava nga mallëngjimi. Dhe ja, që këtej, një mëngjes dimri, u hodha në det e nisa të notoja për të arritur gjer përtej në Korfuz... Ec e ec gjithë ditën. Dhe kur po ngrysej dita, kaloi pranë meje një varkë e huaj. Brenda saj ishin dy njerëz. Më panë e më morën me vete. Unë e kisha bërë gjysmën e rrugës. Teshat që kisha lidhur në kokë, megjithëse më ishin lagur, i vasha. Mbatha dhe këpucët. Nxora portofolin dhe pashë që edhe të hollat më ishin lagur. U shtriva në pupë të varkës dhe atje më zuri gjumi, se isha i dërmuar nga lodhja. Ata të dy që më morën në varkë nuk na paskeshin qenë njerëz të mirë. Ata më morën portofolin dhe më hodhën në det. Në atë kohë që natë e thellë dhe deti ishte i egërsuar. Për një çast nuk mora vesh gjë, po pastaj e mblodha veten, u dhashë me fuqi duarve dhe këmbëve dhe arrita varkën. Desha të hakmerresha me ata njerëz të liq që kishin shkelur

zakonet e detit. Me të hedhur duart në buzën e varkës, kusarët më qëlluan me pabesi në duar... Më qëlluan me kupitë³ e më thyen gishtërinjtë... Më qëlluan edhe në kokë me një stap të rëndë. Dhe unë u lëshova e shkova në thellësitë e detit të nxirë. Erdha në vete. Mblodha gjithë fuqitë e mia dhe dola përsëri mbi ujë. Era frynte si e çmëndur. Dallgët ngriheshin si male. Me mundime - kur gjendesha kaluar mbi dallgën e madhe - dallova se drejtimi, që duhej të merrja ishte andej nga fanari i ndezur i ishullit Oton: Ja, atje! E keni parë atë fanar? Është ende. U tregon drejtimin vaporëve.

- Po, e kemi parë! - tha Loloja. - Pastaj ç' bëre?

- Pastaj luftova me dallgët e egërsuara gjersa u gdhi. Natën deti është i tmerrshëm për ata që nuk e njohin. Po unë e dua detin. Dhe ai më do shumë mua. Deti është si një nënë zemërgjerë. Po e deshe nënën, ajo ç' nuk bën për ty. Por, po nuk e deshe, po e mërzite, po e mashtrove, ajo të mallkon. Mua deti kurrë nuk më ka mallkuar, se unë kurrë nuk jam zemëruar me të... Atë natë i mallkova me gjithë shpirt ata peshkaqenë!

- Pse, u ndeshe me dy peshkaqenë?!

- Po! Me ata dy peshkaqenët që me pabesi, shkelën zakonet e detit e më hodhën në ujë.

- Qëndrove shumë në det?

- Gjithë ditën tjetër. Dhe kur po ngrysej, dola në atë nisi atje...

Unë kisha kohë që i vëreja një shenjë plage të madhe, që i fillonte nga mjekrra e tij e hollë (e cila gati takohej me hundën e gjatë) dhe zbriste në fyt, mospërmes gjoksit e gjer në kërthizë.

- Plagë e kini atë? - e pyeta nga kureshtja.

- Po! Është plaga që më la peshkaqeni kur u përlesha me të.

Heshti. Na buzëqeshi. Dhe me dorën, që kishte gishtërinjtë e kthyer si grepa, përkëdheli shenjën e plagës së vjetër. E kuptoi që ne dëshironim shumë të dëgjonim se si nisi e si mbaroi ajo përleshje legjendare. Ne e kishim dëgjuar nga të tjerët, por jo nga goja e peshkatarit plak.

Ai nuk fliste me njerëzit. Fliste me detin. Po kur i takonte të bisedonte me ata që i shkonin për zemër, s' kishte të pushuar. Siç duket, atëhere gjente rastin të shfrente dufin.

- Po, more bijtë e mi, - vazhdoi ai. - Atë përleshje nuk do ta harroj kurrë, siç nuk do t' i harrojë kurrë edhe fjalët e fundit të plakut tim. Kisha vendosur të hakmerresha. Po peshkaqeni i dreqit ishte shumë i zgjuar. Ai, me të dëgjuar plasjen e dinamitit, ngado që të ishte, nxitonte të vinte këtej për të më ngrënë gjithë

peshqit e vrarë, sepse këtu deti ynë i bukur ka shumë peshq shtegtarë: ka qefuj, kokllane, gruta, shalpe, levrek... E ç' nuk ka! Peshqit që rrinë këtej janë peshq guri, si smirnë, oktapodë, sope, kocë, shalpe, gofe edhe sinagridhë.

Ai numëroi më shumë se dhjetë emra peshqish, po unë doja më shumë të dëgjoja përlëshjen me peshkaqenin.

- Peshqit shtegtarë, tha peshkatari plak, - si qefulli, levreku, gruta, herë vijnë nga veriu dhe herë vijnë nga jugu. Po më të shumtën e rasteve zbresin nga veriu. Unë i pres dhe i vras me dinamit... - Qeshi si peshk. - Tani jo! Tani është ndaluar dinamiti, prandaj peshkoj me grepa... Po meqë ju prisni t' ju tregoj luftën më të rreptë të jetës sime me peshkaqenin, le t' i lëmë këto. Unë isha munduar shumë herë që ta vrisja. Një herë brumosa dhjetra dinamitë bashkë. I bëra gati. E dija që sapo të hidhja dinamitin për të vrarë qefuj, ai do të vinte. Ju e shikoni se sa i thellë është këtu deti. Po s' i nxore menjëherë qefujt e vrarë që rrinë mbi ujë, ata fundosen në thellësitë e shpellave aty brenda, dhe pastaj shko e gjeji. Unë kridhem thellë. Edhe njëzet metra. E mbush trastën, pastaj dal mbi ujë e përsëri kridhem poshtë, duke luftuar me smirnat dhe oktapodët, që gjejnë rastin të rrëmbejnë qefujt e vrarë dhe t' i fusin në vrimat e tyre.

“Një ditë, ja andej nga ajo pllakë, kaloi një re e dendur levrekësh. E hodha dinamitin. Deti u mbush me peshq, që zbardhnin! S’ ka lumturi më të madhe për një peshkatar se sa kur sheh mizëri levrekësh të kthyer me barkun nga qielli. U hodha në ujë e nxora peshq sa munda. Kur ja, arriti peshkaqeni! Ai dreq e nuhat shpejt gjakun e peshkut të vrarë, sado larg që të jetë. Edhe me dhjetra kilometra larg po të jetë, vjen në çast. Me të mbërritur zuri t’ i gëlltiste levrekët si llokume... Ç’ më ndodhi? Kur isha në fund të detit, zura një levrek të madh. Unë i zë nga koka. Po, fap, erdhi peshkaqeni dhe e gëlltiti nga bishti. Unë nuk e lëshova. Siç e kisha zënë peshkun nga koka, e mbërtheva më mirë me të dyja duart dhe i ngula këmbët në shkëmb. Peshkaqeni hiq. Dhe unë hiq. Sa i fuqishëm që është i mallkuari! Hiq unë, hiq ai. Në fund, lëvrecku u nda më dysh dhe mua më mbeti në duar koka e tij. Në atë kohë nxora thikën dhe ia futa peshkaqenit nja dy herë mu prapa veshit. Siç duket i dhembti shumë, prandaj u largua. Uhtë dola mbi ujë dhe hipa, ja, këtu në këtë shkëmb. Isha i inatosur dhe i këputur. S’ ka më i mbrapshtë se peshkaqeni. Ju kini dëgjuar kur shajnë një njeri të keq, zemërlig e gjakësor, i thonë “peshkaqen”! Peshkaqenët me dy këmbë, që rrojnë në stere, janë shumë të dëmshëm... Këtëj nga ne u qëruan. Tani ka shumë përtej detit.

Mjerë ata të gjorë, që kanë të bëjnë me peshkaqenët... Po nejtë... Që thoni ju, sapo e pashë të vinte vërdallë e të kërkonte levrekë të vrarë, mora topin e madh prej dhjetë dinamitësh, ndeza fitilin dhe e vërtita, muratje ku sillej peshkaqeni. Ku plasi, edhe shkëmbinjtë u lëkundën, sikur ra ndonjë tërmet i tmerrshëm. Dhe kur ra mbi det, u duk sikur u rrëzuan kataraktet më fantastike të botës...

Plaku u mendua pak, u mbush me frymë dhe përsëri vazhdoi:

- Për t' u kthjelluar uji, u deshën shumë orë. Unë qëndrova këtu dhe prisja me padurim të shihja peshkaqenin e ngordhur, aty në fund të detit. Po, i habitur, e pashë që vinte vërdallë, duke rrufitur kocat dhe sargonjtë e vrarë nga plasja e dhjetë dinamitëve! Më hipi gjaku në kokë! M' u bë sikur ndjeva zërin e babait që më thërriste: "Merrmë hakun!" S' dija ç' të bëja! Po dridhesha i tëri prej zemërimit. Peshkaqeni, për inatin tim, vinte rreth sikur të luante e të tallej me mua. Nxirte kokën mbi ujë e më shikonte sikur donte të më thoshte: "Më marrsh të keqen!"

"Më lindi një mendim i mrekullueshëm. Mora një levrek të madh nga ata që kisha nxjerrë, i çava barkun dhe i futa brenda një dinamit të tërë. Fitilin e lashë të gjatë Kur sillej peshkaqeni, ja aty poshtë, ndeza fitilin dhe e vërvita në det levrekun me dinamit

në bark. Peshkaqeni, më ta parë, e gëlltiti. Unë desh u çmenda nga gëzimi. prisja nga çasti në çast të plaste dinamiti. “Ma mori të keqen”! thashë me zë. Dhe në këtë kohë u dëgjua një plasje e thellë, si në fund të dheut. Peshkaqeni bëri dhjetra rrotullime të shpejta si elika gjigande e vaporit. Herë i dukej koka mbi det, herë i dukej bishti. Deti u turbullua, sikur po bëhej gameti! Peshkaqeni ende po rrokullisej si një përbindësh i tmerrshëm. Sa i fuqishëm që ishte! Kurrë s’ e besoja që peshkaqeni të mos ngordhte duke i plasur dinamiti në bark. Edhe shkëmbi çahet e thërmohet nga dinamiti!

“Prita shumë minuta për të parë se si do të ndodhte. Peshkaqeni po e humbiste forcën. Pak nga pak e rralloi rrotullimin. U zgjat. E kur e pashë të kthehej me barkun nga dielli, thirra: “Ta mora hakun baba!” Prita se mos dilte mbi ujë. Më kot. Ai po fundosej, dhe arriti ja, mu aty te ajo gropa e thellë që shikoni. Atje u shtri si një nëndetëse. Ç’ të bëja? S’ më punonte më mendja nga gëzimi. Menjëherë mblodha litarin e gjatë të apotomesë. Mora frymë thellë dhe me shpejtësinë dhe forcën e predhës u krodha në thellësi. i afrohesha. Sa i madh që dukej! I drejtohesha picingul kokës së tij, po s’ kisha ç’ t’ i bëja. Brenda në ujë unë mendova t’ i fusja thikën thellë në kafkë e pastaj të lidhja litarin... Mirëpo, ah! Kur iu

afrova, ai më pa me ata dy sytë e tij të xhindosur dhe lëvizi bishtin. Nuk kishte ngordhur ende! Iu turra dhe e kapa për koke me të dy krahët. Dy gishtërinjtë e mëdhenj ia futa në sy. M' u duk sikur kisha mbërthyer një trung ulliri. Ai, përt ja bëri dhe më rrëmbeu e më solli disa herë rrotull. Ngriti shpatën e tij mprehëse të qafës dhe më çau, ja, mu këtu, - dhe tregoi plagën e gjoksit! - Unë e shtrëngova më me fuqi. Dhe dy gishtërinjtë e mëdhenj ia futa edhe më thellë në sytë e tij. Përsëri bëri disa rrotullime të shpejta. Kur e pashë se po fundosej së bashku me mua, nxora thikën dhe me sa fuqi që kisha, ia ngula thellë në trup. Pa humbur kohë, në dorezën xhungë të thikës, ngula dhe përdrodha grepin sa një pash të apotonesë, dhe duke mbajtur bishtin e litarit, u gjenda mbi ujë. Më plasi gjaku nga veshët dhe nga hunda. Nga gjoksi gjaku s' pushonte. U shtriva si i vdekur që të shlodhesha. Më ishin shteruar fuqitë. E ndieja vehten si në bark të peshkaqenit... E dija se ç' duhej të bëja, por ja që s' kisha fuqi të lëvizja gishtin. M' u duk sikur po më tërhiqte. Hapa sytë. Ai vërtetë po më tërhiqte. Ende s' kishte dhënë shpirt!

“Mblodha gjithë forcat e mia dhe me mundime mbinjerëzore arrita shkëmbin, ja, mu aty. Lidha fort litarin dhe erdha dhe u shtriva këtu si i vdekur. Kur erdha në vete ishte pasdreke. Gjaku më ishte mpiksur

në gjoks. Ndjeva dhimbje therëse. U ngrita. Pashë se peshkaqeni ishte aty, i mbërthyer dhe i ngordhur. Kjo më gjallëroi. Ashtu është. Kur del fitimtar njeriu, edhe i vdekur ngjallet. Fitorja të ringjall e të jep forca të reja.

“U ngrita në këmbë. Ç’ të bëja! Si do ta nxirrja armikun e mposhtur? Këtej që e pa mundur. Lidha teshat e mia në kokë dhe u hodha në det. Plaga më digjte shumë. Duke tërhequr peshkaqenin, iu drejtova bregut me zall, ja, atje tej. Duhej ta tërhiqja me fuqi, derisa ta nxirrja mbi ujë, dhe, kur doli mbi ujë, m’ u duk si një varkë e gjatë, si një nëndetëse. Në ujë tërhiqej më lehtë.

“Ende nuk kish perënduar dielli, kur iu afrova bregut. Më kishin parë shumë fshatarë. Ata kishin dalë në ranishte dhe vështrojnë të habitur. Asnjë nuk dinte gjë. Asnjë nuk e priste që unë të tërhiqja një goxha peshkaqen të mundur...

“Kur më njohën u hodhën të gjithë në det për të më ndihmuar. Disa më dhanë dorën dhe më nxorrën jashtë, kurse të tjerët tërhiqnin peshkaqenin. As unë nuk e di se sa ishin grumbulluar. Të tjerë po grumbulloheshin. Lajmi u përhap si rrufe, aq sa arriti deri në fshat. “Ç’ është morë, ç’ është!”, - thoshin - “Niko Daboja paska mundur peshkaqenin!”

Dhe që thoni ju more djem! (Fliste pa marrë

frymë fare! Në të dyja anët e buzëve të tij të holla si të peshkut, i kishte dalë një shkumë e vogël e bardhë... Unë nuk mund ta shikoja... Por sytë e tij më kishin lënë një përshtypje të madhe. Nuk kisha parë kurrë sy të tillë. Herë pas here i shikoja shenjën e trashë të plagës...) E që thoni ju, more djema, me t' u hapur fjala, doli gjithë fshati, i madh e i vogël, për të parë armikun tim të mundur. Lëre mos e pyet se sa vuajtën që ta sillnin në fshat. Njëzet e ca burra mezi e sollën.

“E kishin shtrirë te lëmenjtë, aty poshtë shtëpisë sime. Peshkatarët e tjerë sollën dhjetë damixhanë plot me verë. Të gjithë pinë për fitoren time. Më pas ia nisën valles rreth e rrotull peshkaqenit:

Ku ke qen' o peshkaqen,
S' jemi koce, s' jemi dhen,
S' jemi krimba, o babaxhan,
Jemi burra kapedan...

“Vallja ndizej. Peshkaqeni dergjej i mundur. Po lëre ç' vajtji kur i çanë barkun. I nxorrën nja dy kuintalë levrekë, nga ata që kisha vrarë unë. Po gjëja më e çmuar që i gjetën të ngulur në bark, ishte kjo thikë. Thika e babait tim. Nuk mund ta kuptoni mallëngjimin dhe gëzimin tim! Erdhën dhe ma dhanë duke më thënë: “Të lumtë! E more hakun e babait

tënd! Të lumtë! Na e pastrove detin nga një armik i rreptë!”

“Plagën që më shihni e që ma bëri peshkaqeni me shpatën e tij të mprehtë të qafës, siç iu thashë, ma mjekoi një doktor”.

1. Zbulimi i një të fshehte shekullore

Loloja, që mori si dhuratë thikën e argjendë, m' u duk si kapedan i madh. E mbajti ca në duar. Na e dha për ta parë. Unë i provova majën. Sa e mprehtë që ishte! Dhe sa shkëlqente tehu i saj!

Pastaj Loloja e lidhi në llërën e dorës së majtë. Niko Daboja qau:

- Më vjen mirë që e trashëgove ti! Se unë nuk kam fëmijë. Gjithë djemtë e fshatit, djemtë e mi janë. Kisha menduar t' ja falja më trimit. Dhe më trimi më dukesh ti. Të njoha nga sytë, nga shtati dhe nga fjalët.

Loloja nxori thikën nga milli. E zgjati horizontalisht dhe na ftoi të betoheshim para Niko Dabos:

- **Betohem në heroizmin dhe besnikërinë e kësaj thike të shtrenjtë, se nuk do t' i tregoj askujt fshehtësinë shekullore të Shpellës së Piratëve, që do të na tregojë tani peshkatari i madh i fshatit tonë.**

Ne përsëritëm fjalët që thoshte Loloja. Edhe

Lulja u betua!

Niko Daboja u ngrit në këmbë dhe i dha dorën Lolos duke e uruar:

- U bëfsh peshkatar i dëgjuar! - Pastaj qeshi nën buzë me të madhe. - Unë do t' ua tregoj fshehtësinë shekullore të Shpellës së Piratëve, se ju jeni guximtarë. Por... - u mendua dhe u mendua, - pa uluni pakëz. Uluni këtu.

Dhe ne u ulëm. Lulja i kishte hapur sytë e saj të mëdhenj. Dhe të dy gërshetat e gjata që i binin përpara, nuk i linte të qeta.

Peshkatarin plak na hodhi një sy të gjithëve.

- E shikoni atë? - dhe na tregoi me dorë hyrjen e çuditshme të Shpellës së Piratëve. - Atje deri sot nuk ka mundur të hyjë njëri! Unë jam munduar disa herë të futem por nuk ka qenë e mundur... E shikoni, aty në fund! Uji i detit hyn deri në një vend në një ngushticë si kanal. Njëzet metra më thellë, ngrihet një pllakë, si pengesë për hyrjen e mëtejshme... Unë e arrita me not pllakën! Shpella është e lartë... Po, më e lartë se direku i karavës më të madhe... Unë s' kam parë bukuri të tillë. Si në ëndërr më dukej... Vendosa të shkoj më tutje. U hodha në det, tej pllakës. Uji kishte mijëra ngjyra se drita hynte nga shumë guva të larta e të dendura. Ç' të shihje, more djem! Gaforre sa një samar! Breshka sa një gomar! Nxora thikën.

Notoja lehtë më thellë... Po deti brenda në shpellë s' kishte të sosur! Kur arrita deri në një vend, m' u duk sikur dëgjova një zë si bubullimë: "Ej, ku shkon?"

"U ktheva përsëri. Kur dola, nga u nisa, duke parë diellin e bukur që perëndonte, duke parë rrugën e ndezur që më kishte shtruar dielli mbi det, m' u duk sikur vija nga një botë tjetër. U ngopa me erën e jetës dhe me shpejtësi delfinësh arrita ja, këtu, ku jemi tani..."

Heshti. Tundi kokën.

- Siç duket, piratët hynin deri te pllaka, me felluke të ngushta, të gjata e të shpejta. Pastaj felluket i ngrinin, i kalonin përmbi pllakë dhe i lëshonin në detin fantastik të shpellës...

- Piratët? Po ç' ishin piratët? - pyeti Lulja.

- Piratët... Po... piratët ishin kusarë deti.. vinin nga brigjet e largëta me felluket e tyre të shpejta, rrëmbejnë bagëtinë, digjnin fshatrat, plaçkisnin ç' të gjenin; madje rrëmbejnë edhe djem... Po, djem. I donin ti rrisnin për piratë trima. Ata... e ç' nuk bënë ata për të rrëmbyer djem...

"Gjyshërit tanë luftonin me ta. I prisnin me shigjeta e me ushta, me gurë e me serë të shkrirë e të ndezur. Vinin mijëra piratë dhe ktheheshin shumë pak, të shpartalluar. Rreziku i piratëve i detyroi stërgjyshërit tanë të krijonin togje dhe legjione detarësh trima, me felluke të shpejta. Porsa shihnin që nga maja e Çikës,

atje lart, piratët duke ardhur, ndiznin një zjarr si shenjë alarmi. Kapedanët e fellukeve tona, me të parë zjarrin, me shpejtësi delfini, lëshoheshin drejt perëndimit dhe ndesheshin burrisht me piratët. Beteja në det është e tmerrshme...

“Dhe atëhere kur ishte armiku shumë i madh, tanët, ktheheshin dhe me marifet e shpejtësi futeshin në këtë shpellë. Aty fellukat e piratëve nuk mund të futeshin, se luftëtarët tanë u rrokullisnin gurë të mëdhenj që sipër nga shkëmbi.

“Piratët prisnin të dilnin nga shpella fellukat tona, por ato nuk dilnin... Kalonin ditë e javë dhe fellukat tona nuk dilnin.

“Piratët kujtonin se tanët, patjetër, do të kishin vdekur nga etja dhe uria, prandaj hidheshin në zall e fillonin të ngjiteshin në fshat. Mirëpo, me të hedhur këmbët për në shkallët e monopazit, luftëtarët tanë që ishin futur në shpellë me felluket, u dilnin përpara dhe u vërsuleshin me tërbim.

- Po si ndodhte kjo? - pyeti Loloja i habitur.

- Këtu qëndron fshehtësia e Shpellës së Piratëve...

Peshkatari nuk lodhej së foluri: - Këto që po ju tregoj unë, kisha vendosur t' i merrja me vete në fund të detit... Po më mirë që po ua lë juve, se ju jeni trima, ju jeni stërnipërit e gjyshërve tanë kapedanë.

Siç duket, nga Shpella e Piratëve do të ketë patjetër ndonjë dalje shumë të largët, përtej bregoreve... Siç më tregonte plaku im, në Shpellë qëmoti futej një ujk deti, që quhej kapedan Gjik Mëhill Mërkur Gjonbaba... Dhe thuhej se na ishte stërnip i të famshmit kapedan Gjonbaba...

“Që thoni ju, more djema, ky trim, kapedan Gjike Gjonbaba, që guxonte të futej shpeshherë në Shpellë, na paskësh thënë se nga e majta e Shpellës është një shkallë e në fund të shkallës një hyrje... Atje na paska ndezur një direk karave prej pishe, e, si e ndezi, doli menjëherë jashtë, hipi në Majë të Karavait, atje lart, dhe vuri re në çdo skutë, se mos dilte gjëkund tym. Dhe, siç thotë gojëdhëna, tymi doli nga e majta e fshatit të vjetër.

“Zbriti nga Maja e Karavait, shkoi atje ku dilte tymi dhe gjeti daljen e Shpellës së Piratëve... Unë kam shkuar shpesh herë atje. Nuk mund t’ua tregoj more djema se ç’ çaste fantastike ka atje nën grykën e daljes.

- Po a mund të shkojmë ta shohim? - e pyeti Loloja.

- Është shumë lehtë; mund të shkoni kur të doni. Por me kujdes, mos hyni thellë, se do të rrëzoheni në një hon të errët, ku ka mijëra e mijëra lakuriqë nate... Thonë se kapedan Gjike Gjonbaba u fut për të

dalë në grykë, po s' doli më. Dhe që atëhere, more djem, s' ka guxuar më njeri që të futet...

- Ne do të futemi dhe do të dalim! - thirri

Loloja, duke ngritur lart thikën e argjendë, që i kish falur Peshkatari.

- Jemi gati! - u përgjigjëm ne.

Niko Daboja, i prekur dhe i entuziazmuar nga vendimi ynë, qau.

2. "Gjonbaba! Gjonbaba!"

Ishim kthyer të lodhur në shtëpi. Loloja e ndau sinagridhën në katër pjesë të barabarta.

- Ju do të merrni një pjesë, më tha mua, se motër e vëlla jini, dhe në shtëpi një tryezë shtroni!

Nëna u gëzua për copën e sinagridhës. Ne ishim betuar të mos i kallëzonim njeriu asgjë nga ato që na kish thënë Peshkatari i Madh. Hëngrëm dhe ramë për të fjetur. Lulen e zuri gjumi menjëherë, kurse unë, ashtu siç na porositi Loloja, po mendoja që të gjeja ndonjë mënyrë për t' u futur dhe për të dalë nga Shpella. "Të gjithë duhet të vini me ndonjë plan të studiuar!" na kishte porositur kapedani ynë. Mendo ashtu e mendo kështu, më ziente koka, kur dëgjoj një

zë vajtues: “Gjonbaba! Gjonbaba!”

Mos më bënin veshët? Ç’ ishte ai zë? Kur ja, përsëri, “Gjonbaba! Gjonbaba!” Nëna u ngrit. U ngrit edhe babai! ndezën llambën. “Gjonbaba! Gjonbaba!” thërriste Lulja në gjumë! U ngrita edhe unë.

Babai e zgjoi: - Ç’ ke, moj bijë?

Nëna u tmerrua: - Ç’ është ky Gjonbaba, moj bijë?

Ndërhyra me të shpejtë, se mos i shpëtonte Lules ndonjë fjalë: - Do të ketë parë ndonjë ëndërr! Apo jo, Lule? - dhe vura gishtin në buzë, duke i bërë shenjë që të mos tregonte gjë.

Ajo mblodhi veten dhe u shtri përsëri. Mbylli sytë dhe mëmëriti:

- Vdiqa për gjumë!

U gëzova pa masë, se Lulja, megjithëse ishte përgjumësh, nuk përmendi gjë nga fshehtësia jonë fantastike.

Rashë edhe unë për të fjetur.

Në ëndërr m’ u bë... sikur kisha një felluke të gjatë e të shpejtë. Rremat me të cilat vozitja ishin dy pendë peshkaqeni... Gati fluturoja brenda detit të Shpellës së Piratëve... Thërrisja: “Gjonbaba! Gjonbaba!” Se Gjonbaba e kishim pagëzuar kapedanin tonë, Lolon.

“Gjonbaba! Gjonbaba, ku je?” Në këtë kohë

dëgjoj zërin e nënës, që më rrinte pranë e që më thirri:

- Ç' pate, mor bir! Ç' është ky Gjonbaba?

Hapa sytë. Pranë meje ishin prindërit e mi të shqetësuar. Babai më shikonte me dyshim. Mbylla sytë dhe bëra sikur më zuri gjumi përsëri. Nëna dhe babai po bisedonin:

Babai: - Edhe Lulja, ashtu thërriste:
“Gjonbaba!”

Nëna: Edhe Iliri thërriste “Gjonbaba!”

Babai: Çudi! Mos u kanë trguar ndonjë histori të Gjonbabait!

Nëna: Pse, ç' ka qenë ai Gjonbaba!

Babai: Ka qenë një kapedan i dëgjuar qindra e qindra vjet më përpara... Ai dërrmoi piratët dhe vrau komandantin e tyre Rusman El Namsur...

Kur dëgjova këtë emër: “Rusman El Namsur” nisa të mendoja. Ç' është ky komandant i piratëve, që quhej Rusman El Namsur? Sa e kishte mjekrën! Patjetër që do të kish qenë i zi. Me sy të mëdhenj, me dhëmbë si të peshkaqenit, me thikë të gjatë dhe të mprehtë! Kush e di sa djem do të kish rrëmbyer ai këtej... Po ja, unë, me felluken time, vozitja e përpiquesha të futesha në Shpellë. Më ndiqte Rusman El Namsuri... Me një felluke të gjatë njëqind metra e me njëqind vozitës. Pas tij rrinin qindra felluke të tjera. Unë ktheja kokën pas. Shikoja mu në prua të fellukës

Rusman El Namsurin me thikën në gojë, me duar të hapura, sikur ishte shqiponjë dhe xhybja e tij e bardhë prej cohe ishte e madhe dhe e hapur si pëlhurë gjemie...

Unë futem në hyrjen e ngushtë të Shpellës. Përpiqem të shpejtoj, se po më afrohet Rusman El Namsuri, i cili më bërtet: **“Lala-el - allah - Rusman - il - alla!”**

Dhe unë tmerrohem e bërtas:

- Gjonbaba! Gjonbaba! Ku je? Gjonbaba!

Kur mundohem të zbres nga Shpella, më bëhet Loloja si Gjonbaba, me një shpatë të gjatë... “Mos thirrë!” më thotë ai. “Këtë peshkaqen pirat do ta zhduk nga faqja e dheut! Copë - copë do t’ ia bëj trupin që ta hajnë smirnat, oktapodët dhe peshkaqenët!” Dhe u kthye drejt kryepiratit duke i bërtitur:

- Ku je, ore qen i qenit! Ku je, o Rusman El Namsur! Këtu i thonë Shqipëri! Dëgjon! Këtu, përveç erës, nuk shkel këmbë pirati, se s’ del i gjallë këtej... Dëgjon? Ne jemi bijtë e këtij vendi, që quhet foleja e shqiponjave... Nxirre thikën nga goja jote e ndyrë dhe bëhu gati për dyluftim...

Loloja- Gjonbaba kërcen mbi pllakën që ndante kanalën nga deti i Shpellës, nxjerr nga milli thikën e argjendë që i kish falur Niko Daboja dhe urdhëron:

- Borizan, bjeri borisë. Jep shenjën e sulmit!

- Ta - ta - ta! Ta - ta - ta! - Gjëmoi boria brenda në Shpellë. Që lart, majë shkëmbit, ata që ishin atje roje, me të dëgjuar borinë, zunë të rrokullisnin gurë viganë... Deti ngrinte currila uji gjer në qiell. Nga Shpella dolën luftëtarë... Loloja- kapedan, një të hedhur i bëri thikës së argjendë dhe ia nguli mu në zemër Rusman El Namsurit. Gjaku shpërtheu si një pus i kuq nafte.

Xhybja e bardhë e Rusmanit u skuq, u rëndua dhe ra... Dhe doli trupi lakuriq i kryepiratit! Ç' trup i zi, si trup lubie! Me mundime kërkoi të shkulte thikën nga zemra, po atëhere Loloja- kapedan, me një topuz të rëndë në duar, si Gjergj Elez Alia, i bie balozit të zi... Atëhere Shpella gjëmoi nga hungërima e llahtarshme e kryepiratit, dhe unë u zgjova...

U desh një copë kohë gjersa të vija në vete e të kuptoja se isha në shtëpinë time.

- Nënë! - fola i gëzuar.

3. - Loloja- "Gjonbaba"!

Vendosëm që Lolon ta quanim Gjonbaba.

Mbledhjen e fundit e bëmë te fidanishtja e portokalleve të Vrekës. Ishim nën hijen e një fiku

kallamatë. Hëngrëm edhe fiq. Pastaj u nisëm për te dalja e Shpellës, ku janë dy qipariza të moçëm dhe një karrube e ngarkuar.

Ende s' kishte dalë mirë dielli. Po brigadat e punës kishin kohë që ishin shpërndarë në të gjitha anët.

Ne zbritëm njëri pas tjetrit. Në krye na printe Gjonbaba ynë.

Pas tij shkonte Lulja. Arritëm përmbi pllajën e Shënepremtes. Nuk u munduam shumë për të gjetur daljen e shpellës. I pari zbriti Gjonbaba.

- Pritni këtu! - na porositi.

Dhe ne pritëm. Na ftoi të zbritnim. Dhe ne zbritëm. E ç' të shikonim! Një shpellë e gjerë me një kube mbushur me stalaktite të çuditshme që dukeshin si statuja mijëvjeçare me forma të ndryshme. Disa ishin si kolona, nga ato të Apolonisë dhe të Butrintit.

Ne heshtëm. Era brënda ishte e freskët, si në frigorifer dhe shumë e rëndë. As frymëmarrja jonë nuk ndihej. Asgjë nuk pipëtinte. Ishim të mahnitur nga bukuria fantastike e formave të habitshme dhe artistike të statujave të heshtura.

- Këtej dilnin stërgjyshërit tanë trima! - Tha Gjonbaba ynë. - Po edhe ne, stërnipërit e tyre, do ta kalojmë këtë shpellë... - Zëri i tij u përsërit shumë herë nga oshëtimi.

Nisëm të lëviznim pakëz. Pamë në të gjitha

skutat. S' gjetëm gjë. Atje lart ishte një si tribunë guri. Këtej, një shesh i gjerë. Në atë tribunë - guri, siç duket, do të kenë qëndruar dikur kapedanët. Gjonbaba ynë erdhi rreth në të katër anët e shpellës. Kërkonte të gjente se nga mund të kalohej për të dalë te Shpella e Piratëve. Shkoi më poshtë. Gjeti një hyrje të rrumbullaktë sa gryka e një voze të madhe. Iu afrua. Brenda errësirë pusi. Nxori elektrikun e dorës. E ndezi. Hodhi dritën thellë, po nuk dukej gjë veçse një boshllëk i errët dhe i pakufishëm. Hodhi një gur të vogël. Nuk u dëgjua se ku ra. Mori një gur më të madh. E hodhi. Mbajtëm vesh. Përsëri nuk u dëgjua gjë! Mori një gur shumë të madh, që mezi e ngriti. E afroi te hyrja e rrumbullakët dhe e rrokullisi. Asgjë nuk u dëgjua!

Gjonbaba ynë u kthye, hipi në një tribunë prej guri, ku stalaktitet ishin të harmonishme, nxori thikën e argjendë e ngriti lart dhe foli:

- Shokë! Rruga që të nxjerr nga Shpella e Piratëve e gjer këtu ku jemi ne, u gjet. Atje ku u hodh guri i madh, nuk u dëgjua gjë. Ajo është rruga jonë!

Lulja mezi kapërcente pështymën. Edhe ajo rrinte gatitu si ne. Fotoja, si breshka, kishte futur kokën në jakën e xhaketës. Jani dukej si një ushtar i gatshëm për sulm. Rreth qafës mbante një litar të mbledhur.

- Tani unë do të zbuloj atë hyrje atje, dhe do

të zgjidh misterin sepse nuk u dëgjua guri i madh që u rrokullis brenda. Ne kemi katër litarë të gjatë. Domethënë, po t' i lidhim njëri pas tjetrit, mund të arrijnë afro njëqind metra. Pra, unë do të zbres njëqind metra thellë...

Tha këto dhe lidhi litarët, vari në gjoks elektrikun e gjatë, thikën e siguroi mirë në llërën e dorës së majtë; kishte përgatitur edhe një maskë; e vuri edhe atë në fytyrë, e dukej tamam si Gjonbaba. Pasi e pat lidhur njërin bisht të litarit pas trupi të tij të fortë, tjetrin e lidhi në një kolonë guri, aty pranë grykës së rumbullakët, dhe thirri i gëzuar:

- Gati!

Pastaj na hodhi një shikim. Po ç' shikim! Maska e tregonte si një pirat të regjur. Xhamat e syzave të maskës ishin të mëdhenj dhe dukeshin si sy kuçedre. Unë e shikoja i habitur, po dhe krenar që kisha një udhëheqës të tillë të guximshëm. Si vendosi të zbriste në atë hon të zi?! Po ta sulmonin mijërat e lakuriqëve të natës? Po të këputej litari, ku do të binte?

- Shoku Gjonbaba! - fola unë, pa dashur. Po ç' desha të thosha? - Shoku Gjonbaba! - përsërita kot.

Të gjithë heshtën dhe u kthyen nga unë.

- Ç' ke? Fjolë! - më nxiti të flisja kapedani ynë.

- Po! Shoku Gjonbaba! Unë mendoj se vendimet duhet t' i marrim bashkë!

Heshtje.

- Pastaj? - pyeti Loloja duke tundur thikën e varur në llërën e dorës së majtë.

- Unë, - vazhdova të flisja, dhe më dukej sikur nuk ishte zëri im ai që dëgjohej, - mendoj se vendimi që more për të zbritur ti vetë, nuk është i drejtë... Duhet ta diskutojmë. Pastaj të vendosim.

Dhe ashtu u bë. Pasi u bisedua nga të gjithë, u vendos që Gjonbaba, kapedani ynë, të zbriste i pari. Ashtu ka qënë zakoni ynë. Dhe këtë zakon ne e mbajmë. E mbajtën partizanët në luftë, ku në ballë sulmonin komandantët...

Sa mirë fliste Gjonbaba ynë! Po ai kish mbaruar klasën e tetë, dhe tani shkonte në të nëntën, kurse ne sivjet do të bënim të shtatën, përveç Lules që do të bënte të gjashtën.

- Pra, - përfundoi Gjonbaba ynë, - tani unë do të zbres. Ju do të mbani litarin. Dhe do ta lëshoni dalëngadalë. Në qoftë se unë fishkëllej tri herë, ju tërhiqeni menjëherë...

Tha këto dhe u afrua në buzën e hyrjes së rrumbullaktë si gryka e vozës. Ndezi elektrikun. U mbajt te litari dhe nisi të zbresë, duke mbështetur këmbët në faqen e këtejme. Unë e vura re se si nisi të

na humbiste nga sytë. Më në fund i pashë vetëm kokën. I pashë fytyrën e maskuar, dhe m' u duk si një djalë, që zhdukej në errësirë. Humbi fare!

Ne, duke lëshuar shumë ngadalë litarin, mezi merrnim frymë. Zemra na bënte "duk - duk"! Litari lëshohej e lëshohej, siç lëshoheshin edhe shpresat tona për jetën e Lolos.

Lulja mbushi sytë me lot. Fotoja nuk guxonte të na shikonte në sy. Litari lëshohej e lëshohej kur Fotoja thirri:

- Mjaft! Si e lejuam? Po ta mbysin lakuriqët e natës? Nuk e lëshoj më litarin! - dhe nguli këmbët, si kau kur tërheq parmëndën.

Litari nuk lëshohej më.

- Ta lëshojmë! - bërtiti Jani. - Urdhëri është urdhër! Jemi në betejë dhe urdhërat nuk prapsen. Ai që prapset është i humbur. Lëshoje litarin, Foto! Përndryshe je përgjegjës!

Fotoja, kur dëgjoi fjalët e fundit, tundi kokën dhe lëshoi litarin.

Shpella të përpinte me ato statuje, që merrnin pamje të ndryshme: disa dukeshin si njerëz gjigandë me kokë të gjatë pesë metra, disa si piratë me mjekër gjer te këmbët...

Litari lëshohej. Lëshohej dhe as unë nuk e di pse të katër kthyem kokën nga buza e hyrjes si grykë

voze. Mua m' u duk sikur dëgjova një fëshfëritje. Edhe të tjerët rrinin me veshë të ngritur.

- Dëgjove gjë? - më pyeti Jani.

- Po ti? - ja ktheva unë.

- Më zuri veshi diçka! - murmuriti Fotoja.

- Çfarë?! - pyeti e llahtarisur Lulja.

- Pushoni! - porositi Jani.

Litari lëshohej e lëshohej. Edhe pak... edhe pak dhe mbaronte. Të them të vërtetën, mua m' u drodh zemra kur përfytyrova se si do të ishte tani Gjonbaba ynë... "Ama, vërtet Gjonbabë qënka. Guximtar. I vendosur", mendova.

Litari mbaroi. U tendos. Që të katër, me zemrën peshë, prisnim të dëgjonim tri fishkëllimat. Prit e prit e asgjë! Litari tendosej më fort. Shikonim njëri - tjetrin në sy dhe s' dinim si të vepronim tani. Ta tërhiqim? Ç' të bënim?

Jani, duke shkarë duart në litarin e tendosur, iu afrua buzës së shpellës, me grykën si rrethi i vozës. Zgjati kokën. Thirri:

- Gjonbaba! Gjonbaba! Gjonbabaaaaa!

Heshtje! Asnjë përgjigje. Asnjë shenjë jete për kapëdanin tonë.

Lulja, si më e vogël, ja shkrepiti të qarit.

- Po të qash, do të përjashtojmë nga rrethi ynë! Dëgjon? - i bërtita unë. Ndonëse edhe mua më

vinte për të qarë.

- Si e lamë? Si e lamë? - përsëriste Fotoja.

Litari rrinte shumë i tendosur. Dhe tetë duar e shtrëngonin me ankth. Statujat na shikonin. Mua më bëhej sikur sytë e tyre prej guri talleshin me ne.

Iu afrova edhe unë buzës së grykës si rrethi i vozës. Zgjata kokën. Një afsh i ftohtë i errësirës së thellë gati sa s' më zuri frymën... Desha të fishkëlleja, po nuk munda. "Po sikur të jetë sulmuar nga lakuriqët e natës? Po sikur t' i jetë zënë fryma nga kjo erë mbytëse e vdekjes?" mendoja unë.

Bëra disa hapa prapa. Ktheva kokën. Shokët më shikonin të pushtuar nga një shqetësim ankthi dhe frike. Njëmijë mendime të zeza më vlonin në kokë.

Kaluan edhe shumë minuta. Dhe ne të katër po bëheshim si statujat e stalaktiteve... Ishim ngrirë.

- Duhet të bëjmë diçka! - thirri e ngashëryer

Lulja.

- Çfarë? - pyeta unë.

- Të tërheqim litarin! - tha i vendosur Jani.

- Të tërheqim litarin! - përsëritëm të gjithë me

një zë.

Dhe nisëm të tërheqim litarin, ashtu siç tërheqin rrjetën peshkatarët.

"Ho-hopa! - Ho-hopa! Ho-hopa!" Sa i rëndë na dukej Gjonbaba!" Po sikur... po sikur, të mos jetë

Gjonbaba, po ndonjë përbindësh që ka mbërthyer
Gjonbabën tonë!

- Nuk tërhiqet dot! - U dëgjua zëri i Janit.

Fotoja: (me lot në sy): - Po sikur të ketë
vdekur? se i vdekuri është plumb i rëndë...

Jani: - Nuk vdesin kapedanët...

Unë: - Asnjë pëllëmbë litari s' kemi tërhequr.

Lulja: - Të vemë gjithë fuqitë tona... S' duhet
ta lemë më poshtë në humnerën e errët Lolon! O
burra, tërhiqni! Tërhiqni!

“Ho-hopa! Ho-hopa! Ho-hopa!” Hiq e tërhiq.
Me të gjitha fuqitë tona.

“Po sikur të vemi e të lajmërojmë! - mendoja
unë. - Të lajmërojmë rojat bregdetare! Ata kanë
mjete; kanë prozhektorë; kanë litarë të fuqishëm; kanë
fuqi, se janë roja...”

Kur... ja, aty në buzën e Shpellës, me grykë
si të vozës së madhe, u duk një kokë fantazme. Apo
më bënë sytë? Jo! Kokë fantazme!

Vura re se të tetë duart ngrinë. U lëshuan. Po
litari i lidhur në kolonë, ishte i tendosur. Vura re se
edhe të tjerët ishin bërë dyllë të verdhë, më të verdhë
se kolonat e çuditshme të stalaktiteve. Dhe sytë i
mbanin drejt fytyrës së fantazmës.

Besoj, se e para që do të kishte uluritur, do të
kishte qenë Lulja, po të mos kishte folur ajo fytyrë e

tmerrshme.

- Mos e hiqni litarin!

Ishte zëri i Gjonbabës! Dhe ne kishim harruar, se ai kishte venë në fytyrë atë maskë me sy të mëdhenj, si të ndonjë përbindëshi.

Ai doli! Po ne ishim bërë si kolonat e çuditshme të stalaktiteve. Nuk lëviznim. Ishim shastisur. E kishim humbur!

- E, more shokë! Pse s' flisni? - na foli Gjonbaba duke hequr atë maskë, që na tmerroi. Në njërën dorë ai mbante disa gjëra të zeza.

- Ç' janë ato? - i pari foli Fotoja. Dhe iu afrua.

Unë u zemërova me të. Në vend që t' i hidheshim e ta përqaфонim, se më në fund ja te erdhi shëndoshë e mirë nga homi, Fotoja vete dhe e pyet: "Ç' janë ato?" Mor, me të vërtetë, ç' janë ato?

Gjonbaba shkoi dhe e zgjidhi litarin nga kolona, e zgjidhi dhe nga mesi i tij. Na vështroi edhe një herë dhe urdhëroi:

- Shpejt të dalim, se më zihet fryma. Dua të ngopem me erë të lirë... Dua të shoh diellin dhe detin... se vij nga skëterra...

Tha këto dhe vrapoi për te gryka e daljes. Të gjithë, pa bërë zë, e ndoqën pas. Dhe dolëm përjashta.

Gjonbaba hoqi menjëherë maskën, thikën, brezin, elektrikun, që i varej në gjoks... dhe na u kthye

në Lolo.

Ngriti duart lart dhe nisi të marrë erë lirisht duke lëvizur krahët e duke fryrë gjoksin.

Pa qiellin. Pa detin. Pa fshatin. Pa Malet e Vetëtimës:

- Ç' bukuri të rralla që ka jeta! Ç' vend fantastik që kemi! O erë, o det, o shokë, sa ju dua...

Dhe u lëshua e na përqafoi me rradhë.

Lulja u afrua te ato gjëra të zeza që i kishte hedhur tutje Lolua:

- Janë lakuriqë të natës që vrava... Unë shpartallova me qindra... Po as unë nuk e di se ku binin... M' u vërsulën aq shumë, sa më mbuluan edhe dritën e elektrikut... Këta që solla, i mora për të parë se ç' kafshë janë ato që rrojnë në atë pus të zi, ku të zihet fryma...

I pamë me kureshtje ata shpendë pa pëndë! Shumë të pështirë na u dukën! Po me habi pamë edhe duart e përgjakura të Lolos.

- M' u vërsulën me qindra, po shyqyr që kisha maskën, - se do të më kishin nxjerrë sytë!

Ne heshtnim si të mpirë. Dielli kishte puthur detin e gjerë dhe kopshtet e pambaruara me ullinj e portokalle. Këtej lart, nga rruga, një makinë uturinte.

- Tani, - tha Loloja, - u zbulua dalja... Po pse nuk më tërhoqët kur fishkëlleva tri herë?

- Nuk dëgjuam gjë! - u përgjigj Lulja...

- Si nuk dëgjuat gjë? Unë i përsërita shumë herë dhe shumë me fuqi fishkëllimat!

- Jo! Ne as që dëgjuam gjë fare! - tha Jani.

- S' dëgjuat gjë? - pyeti i menduar Loloja. - Po atëhere... atëhere... prandaj s' u dëgjua dhe guri i madh që hodha! Çudi! andaj dhe mua më dukej sikur isha shurdhuar fare... U zgjidh misteri... Unë, Aty në grykë të shpellës, duke u ngjitur, zbulova dy ganxhe-çengelë shumë të fuqishëm dhe të futur në shkëmb. Siç duket, të parët tanë aty varnin ndonjë shkallë vigane... ndryshe, s' kuptohet! Ç' hyjnë në punë ata dy ganxhe-çengelë, sa ankorat e vaporëve të mëdhenj!

Na fliste dhe na shikonte. Pastaj na tha këto, që ne kurrë nuk i prisnim:

- Unë mendoj të provohet cilido nga ju, në vijën e parë të betejës... Se kemi shumë për të bërë! Kemi përpara nesh detyrën e rëndë: zbulimin e Shpellës së Piratëve.

- Jemi gati! - thirri Jani.

- Unë mendoj të zbrisni me radhë aty ku zbrita unë!

Hodha sytë nga e majta ime dhe pashë Foton. E futi më thellë kokën në jakën e xhakëtës prej doku; zgjati mjekrën dhe uli sytë.

- Unë mendoj, - fliste tani Loloja-Gjonbaba,

- që Lulja të zbresë pesë metra dhe të qëndrojë pesë minuta. Fotoja dhjetë metra, dhe të qëndrojë dhjetë minuta. Iliri të zbresë pesëmbëdhjetë metra dhe të qëndrojë dhjetë minuta. Jani të zbresë njëzet metra dhe të qëndrijë dhjetë minuta.

Heshtje. Frynte një fllad bunace³. Disa zogj fluturonin mbi kokat tona. Më poshtë, në kopshtet e ullinjve oshëtinte kori monoton i cinxërve.

Lulja: - Pse të zbres unë më pak se të gjithë?

Fotoja: - (E shikon me inat): - Mos dëshiron të marrësh edhe dhjetë metrat e mia?

Lulja (Fotos): - Ti je frikacak!

Fotoja: (Nxori kokën si breshka. Me zë të lartë): - Shoku Gjonbaba! Ç' thotë kjo? Frikacak jam unë? (Lules) Ku e vure re ti, moj trime, se unë qënkam frikacak?

Loloja-Gjonbaba: - Tani do ta provojmë. Ne s' duhet të kemi frikë. Frika është e huaj... Kurrë nuk është shfaqur në fshatin tonë. thonë se, një herë, ka provuar të hyjë, po gjeti belanë. E shqepën në dru dhe i thanë: "Gjete tokë të mbish! Pa na u zhduk syve se do të të punojmë qindin... gjidi frikacake!" Dhe ajo, me bisht në shalë, u hodh në det, dhe kushedi se në ç' breg do të ketë dalë! Frika është e shëmtuar dhe shëmtimin ja ngjit atij, të cilit i futet në bark! Frika është turpi më i shumtuar, dhe turpin ia ngjit atij të cilit

i futet në bark!

Jani qeshi. Qeshi dhe Fotoja.

Loloja-Gjonbaba: - Unë mendoj që t' u bëjmë një letër atyre shkencëtarëve, që rrinë në Tiranë e bëjnë libra dhe fjalorë dhe t' u themi që fjalën *frikë* të mos e vënë më në asnjë libër dhe në asnjë fjalor! Tani, si thoni? Cili do të zbresë i pari? Ai që dëshiron të zbresë i pari, letë bëjë një hap përpara.

Menjëherë, që të katër, bëme nga një hap përpara.

PJESA E TRETË

1. Përgatitja

Këmbët nuk na zinin vend. Zbatonim urdhërat, që na jepte Gjonbaba ynë. Na ish mbushur mendja se do të futeshim thellë në Shpellën e Piratëve.

Unë nuk e kisha shumë të qartë ç' do të thoshte fjala "pirat", prandaj, një pasdreke, iu afrova mësuesit, atje te rrapi pranë burimit, ku rrinte gjithnjë e lexonte gazetën dhe e përshëndeta, dhe ai, pasi e kuptoi që unë do ta pyesja për diçka, ashtu siç bëja shpesh herë, më foli vetë i pari:

- E, Ilir, ke ndonjë pyetje?

- Si urdhëron!

- Pa ta dëgjojmë!

- Kam dëgjuar të flitet për *piratët*! Ç' kanë qenë piratët?

Mësuesi hoqi syzat, palosi gazetën dhe, duke

parë ujët e burimit, që rridhte duke shushuritur, tha:

- Piratët? Piratët, në të kaluarën, na kanë dëmtuar shumë. Ata ishin detarë të guximshëm, që rronin me plaçkë. Sulmonin karavet dhe gjemitë dhe u merrnin ç' kishin e nuk kishin ngarkuar... (Mësuesi fjalët i nxirrte shumë ngadalë. Mendonte...). Po, piratët ishin detarë pa flamurë, pa ligje, pa njerëzi... Se duhet ta dish se çdo karavë, apo gjemi, mban një flamur! Flamurin e shtetit të tij. Kurse piratët s' kanë pasur flamurë... Deti ishte i tyre... Vinin edhe këtu... Dhe na dëmtonin shumë.

Ai fliste dhe unë mendoja për Shpellën e Piratëve. U mata t' i ndërprisja fjalën dhe t' i thoja: "Ç' dini ju për atë Shpellë?" Po shyqyr që nuk i thashë gjë, se atëherë do të shkelja betimin...

E falenderova. Ai më hodhi një shikim si i menduar dhe, para se të largohesha, më pyeti:

- Si t' u shkrep, more Ilir, të pyesësh tani për piratët?

- Ashtu kot!

- Hë-hë! - ia bëri përsëri si i menduar mësuesi...

Mua më dogji! Pa tjetër që mësuesit do t' i kishte rënë era... Sidoqoftë, unë isha betuar të mos i kallëzoja njeriu... Mirëpo ata piratë të guximshëm si s' mbanin flamur? Pse Niko Daboja

na kish thënë që ata si flamur kishin një pecë të zezë me një kafkë të bardhë në mes?

Kisha gjetur sqeparin dhe një daltë, ashtu siç na kish porositur Gjonbaba ynë. Dhe të nesërmen, që pa gdhirë, shkova te vendi që kishim caktuar. Sa mirë është të zgjohet njeriu shumë herët! Atëherë kur gjelat këndojnë për herë të dytë, se kur këndojnë herën e parë është mesnatë.

Shokët më prisnin. Urdhëri ishte zbatuar: Lulja nuk do të vinte. Prandaj dhe unë nuk e mora.

Zbritëm nga monopati shumë i rrezikshëm i Shën Marinës dhe arritëm në Saraqinisht.

- Unë besoj se ky vend, që quhet Saraqinisht, vjen nga Saraqenët! - tha Gjonbaba ynë. - Siç duket, në këtë vend do të jetë bërë ndonjë betejë e fortë, ku do të kenë ngrënë dru Saraqenët.

- Nga vinin Saraqenët? - e pyeta Foton.

- Nga bregdeti i Afrikës! Ose edhe nga Siçilia që kishin pushtuar... Kam lexuar një histori, që thoshte se Saraqenët ishin munduar të pushtonin edhe vendin tonë, se ky vend është shumë strategjik, kontrollon gjithë kanalën e Otrantos. Pastaj ata e panë që ky vend është si kështjellë e pathyeshme dhe, po ta pushtonin, do t' i sulmonin më lehtë karavet që kalonin kanalën e Otrantos. Mirëpo këtu gjetën zotër të vendit. Gjetën

të parët tanë, që nuk i lanë kurrë të hidhnin këmbën mbi këtë truall...

Ne e dëgjonim. Ku i dinte gjithë këto histori Loloja!

Poshtë nesh deti flinte. Sa i bukur është deti në këtë kohë! Vala s' lëviz fare!

Njëri pas tjetrit, duke kaluar nga vende të fshehta, që të mos diktoheshim, arritëm në Al Evra!

- Edhe ky vend, që quhet Al Evra, emër saraqenësh ka!

- Ç' do me thënë Al Evra? - e pyeti përsëri Fotoja!

- Di unë? Kur të mësoj arabishten, do të ta them...

Në një shpellë të gjerë, aty në Al Evra, kishim rrokullisur me shumë mundime një trung të madh e të gjatë lisi. Ditë të tëra ishim munduar sa e futëm në atë shpellë, buzë detit, ku rëra ishte gjithnjë e lagur. Ditë të tëra e kishim qëruar dhe prerë me sharrë. Tani, me daltë e me sqepar, duhej ta gdhendnim e ta bënim si një felluke të shpejtë e të gjatë... Po, ishte shtatë metra i gjatë trugu i drejtë.

Pasi na caktoi Gjonbaba ynë vendin ku do të punonte secili nga ne, që të katër filluam nga puna.

"Tak-tuk!" - "Tak-tuk!" - oshëtinin në shpellën e madhe sqepari dhe dalta.

Puno e puno, gjiri i trungut hapej e hapej si një magje e madhe, si një lug i gjatë.

Punonim pa bërë fjalë, por duke menduar gjithnjë për gjërat fantastike, që do të gjenim te Shpella e Piratëve:

“... Kur do të futemi në atë det - shpellë të mrekullueshme, unë do të vras një gaforre të madhe sa një derr... ose një breshkë sa një gomar... dhe kur ta sjell në fshat do të mblidhen të gjithë për të na parë... dhe Niko Daboja, edhe unë, do të mburremi me gjahun e jashtëzakonshëm... Po sikur të gjejmë armët e Gjonbabës? Pa tjetër ato do t’ i ngjeshë Loloja! Se atij i perkasin. Është kapedani ynë! Unë mund të ngjesh armët e Gjonbirit! Jo! Ato i perkasin Janit, se Jani është shumë i guximshëm... Atëhere mua do të më perkisnin armët e Gjonipit!”

- Mjaft! - më trembi urdhëri i Lolos. Sot punuam shumë! Tani të çlodhemi... Dhe pastaj bëjmë edhe një banjë të mirë, se po na e bën deti me sy... Si thoni?

- Po si do ta pagëzojmë fellukën tonë? - pyeti Jani që kullonte në djersë.

- E kam menduar! Kam zgjedhur disa emra. Dhe do t’ i shohim bashkë. Më mirë mendohuni edhe ju! - tha Gjonbaba ynë.

- Po sikur ta pagëzojmë “*Vetëtima*”!? - tha

Fotoja.

Unë aty për aty u përgjigja: - Jo, se **“Vetëtima”** quhet skuadra e futbollit.

Dhe u krodha në mendime për të gjetur ndonjë emër të bukur e fantastik. Mirëpo u bëra kureshtar për emrat që kishte ndër mend Gjonbaba ynë, prandaj e pyeta:

- A mund të na i thuash emrat që ke gjetur?

- Posi! - dhe qeshi - **“Gjonbaba!”**, **“Partizani!”**, **“Fellukja misterioze!”**, **“Zbuluesja heroike!”** por emri që më pëlqen më shumë është **“Delfini i Pionierëve!”**

- Edhe mua më pëlqen shumë ky emër! - bërtiti Fotoja duke ngritur duart. Dhe përsëriti me krenari, duke marrë një pamje burrërore: - **“Delfini i Pionierëve!”** Hajde, hajde! Unë do të jem timonieri!

Ë pashë dhe desha t' i thoja “Ama e paske zgjedhur detyrën tënde!” po Jani s' më la, se thirri:

- Edhe mua më pëlqen ky emër! Dhe përsëriti: **“Delfini i Pionierëve!”**

Vendosëm që fellukën tonë ta quanim **“Delfini i Pionierëve”**. Kur e mbaruam së lyeri, Loloja shkroi me shkronja të mëdha e të bardha **“Delfini i Pionierëve!”**, dhe në drekun e vogël ngritëm flamurin e marinës sonë luftarake.

- Pse Flamurin e Marinës luftarake? - pyeti Fotoja. - Të vëmë flamurin tonë kombëtar.

Përsëri biseduam e biseduam, gjersa më në fund u vendos që të jetë flamuri i Marinës sonë luftarake.

E vendosëm kështu sepse Gjonbaba ynë na tha: - Ne jemi luftëtarë. Ne nisemi për në betejë. Dhe beteja jonë është shumë e rëndësishme dhe e vështirë... Kushedi, në këtë betejë, duke kërkuar gjurmët heroike të së kaluarës sonë, ka mundësi që të biem të gjithë në fushën e nderit.

Atë mëngjes kishte ardhur edhe Lulja. Gjonbaba ynë, pasi e pa mirë "*Delfinin e Pionierëve*" në gadishnëri luftarake, na urdhëroi të zinin vendet e caktuarat. Dhe vetë ndenji më këmbë, në prua, kurse në pupë zuri vend Lulja, duke mbajtur timonin. Unë isha caktuar në mes. Përpara kisha Foton dhe pas Janin.

Ngritëm rremat sipas urdhërit të Gjonbabës, dhe i mbajtëm në erë sikur të ishin gjashtë krahë të ndonjë karkaleci vigan, gati për të fluturuar.

2. Në sulm! Për futjen në Shpellë

Natën, duke gdhirë pesëmbëdhjetë gushti

i vitit 1963, nuk do ta harroj kurrë! Unë tërë atë natë nuk mbylla sy! Kthehesha sa nga njëri krah në tjetrin; isha i turbulluar. Mendimet e mia ishin aq të shpejta, sa nuk u kapja dot fillin. E ç' nuk më shkonte ndër mend!

“Po sikur të mos kthehemi më? Dhe ne jemi dy: unë edhe Lulja! Dhe babai dhe nëna, vetëm neve të dyve na kanë! Kurse Fotoja ka vëllezër e motra. Edhe Jani ka vëllezër. Kurse Loloja është djali i vetëm. I gjori xha Stefo! Tërë jetën ka punuar e ka punuar! I ka rënë bretku! Edhe në mërgim ka shkuar për të fituar bukën e gojës! Ashtu e mbaj mend unë: me shatë në krah. Me atë trup të gjatë e të nxirë! Është ata dhëmbë të kalbur... Siç duket, Loloja i ngjan shumë. Gjallë xha - Stefo është! Po sikur të na përpijë Shpellë? Po sikur atje brenda të ketë kuçedra! Të ketë gaforre që të shqyejnë!

Më vjen keq për Lulen! Ajo është më e vogël se ne! Sa herë i jam lutur që të mos vijë! Po ajo qanë e më drejtohet tërë inat: “Jam partizane unë! Lufta që bënë partizanet mos ka qenë më e vogël se ajo që bënë partizanët? Mos ma thuaj më këtë fjalë, se është turp për ty”!

M'u duk sikur isha mbytur në djersë, megjithëse edhe çarçafin e kisha hedhur tutje. Babai dhe nëna flini të qetë. Edhe Lulja flinte e qetë! Kur

papandehur thirri: **“Voga! Voga! Shpejtoni rremat, se e kaluam! E kaluam!”**

Unë, i hutuar, u ngrita dhe iu afrova. Drita e hënës, që hynte nga dritarja e hapur, i binte në fytyrë. Ajo qeshte në gjumë. Kush e di ç’ ëndërronte! Desha ta zgjoja, por më erdhi keq. E lashë ta vazhdonte atë ëndërr të bukur që shihte.

U shtriva. E mbulova kokën me çarçaf. Po si peshku në stere kthehu këtej e kthehu andej; nuk kapja dot fillin e mendimeve të mia, që më turbullonin kokën.

Çarçafin e hodha përsëri tutje! Ç’ vapë! Isha djersitur!

“Po sikur të futemi thellë e të mos dalim më? Dhe nuk i kemi thënë njeriu! Pse të mos ia thoshim mësuesit të fizkulturës? Ai është i fuqishëm. Dhe i zoti! Pse të mos ia thoshim Niko Dabos? Ai do të na udhëzonte... Dhe mund të vinte me ne! Vërtet plak i n oçëm është, por zemrën e ka fare të re! E pse të mos ia thoshim oficerit të rojave bregdetare? Ai është i zoti dhe ka gjithë ato mjete... Po sikur të mos kthehemi?”

- Përpara! Arritëm! Të lumtë, Ilir! - thirri përsëri në gjumë Lulja.

U ngrita përgjysmë. Dhe, të them të vërtetën, më erdhi turp nga vetja për mendimet që më mundonin. Pse të mos merrja anën fitimtare? Ne për të fituar

jemi përgatitur dhe jo për të humbur. Sa keq, kur njeriu mendon të keqen! Mirë na e tha Loloja: “Ne do të fitojmë! Dhe të gjithë do të flasin për ne! Të gjithë do të na e kenë zilinë!”

Krisi kënga e dytë e gjelit! Erdhi ora! Zemra nisi të më rrihte me shpejtësi të madhe.

Lart, në kështjellën e Shën Mërisë, që zotëron fshatin, u dëgjua kënga e ëmbël e vashave. Kënga, si një ligjërim harmonioz, e bënte natën me hënë më harmonioze:

Vashat këndonin këngën e një partizaneje trime, që shpëtoi shokët nga rrethimi. Tingujt e mallëngjyer e të trishtuar, por heroik, ma ndezën zemrën. Edhe unë e dua shumë atë këngë partizane. Sa herë e kam kënduar!

Me ngadalë zgjova Lulen! Ajo, sikur i shkela një sustë, menjëherë u gjend në këmbë dhe më pyeti:

- Mos jemi vonë?
- Jo!
- Shpejto, Ilir!
- T’i marrim të gjitha!
- Ku i ke lënë?
- Pas fikut! Eja...

U veshëm. Në majë të këmbëve iu drejtuam derës. Lulja, për çudi, u fut në dhomën e prindërve. Unë sa nuk plasa nga zemërimi! “Ç” kërkon ajo atje

tani? Mos u ka treguar gjë?” Dhe ja, ajo doli në majë të këmbëve...

Morrëm ato që kishim për të marrë dhe dolëm. Ja mbajtëm nga ullinjtë. Hija e tyre nën hënën e plotë formonte mijëra figura shtazësh të çuditshme. Ne ecnim. Unë përpara. Pas meje Lulja. Dhe kënga që oshëtinte, atje lart në kështjellën e vjetër, na bënte më të mallëngjyer. Po, të mallëngjyer e të prekur, se kishim lënë prindërit në gjumë dhe kishim marrë rrogen e një beteje shumë të çuditshme por edhe shumë të rrezikshme.

Pa fjalë dhe të rënduar nga mendimet tona, arritëm te Shpella në Al Evra. *“Delfini i Pionierëve!”* ishte aty, i mbuluar me gjethe bananeje të mëdha. E zbuluam! E pamë! Sikur shihnim anijen tonë kozmike. Sikur shihnim krahët tanë. Sikur shihnim armën e fitores.

Gjonbaba ynë na urdhëroi:

- Siç ju kam porositur! Çdo send në vendin e vet. Me kujdes! Mos harroni asgjë!

Menjëherë u shpërndamë në të katër anët e kamareve të thella të Shpellës, ku me ditë të tëra kishim sjellë një e nga një të gjitha mjetet që na duheshin për ekspeditë: Lëmshe me spango, litarë, fanarë, (nga ata që prindërit tanë përdornin netëve me furtunë), thika, shkrepëse, tri kosha me fruta

(pjeshkë, dardhë, fiq, rrush, etj.), shtiza, një tigan, bukë, një shtambë me ujë e të tjera.

I vendosëm të gjitha në vendet e caktuara mbi fellukën tonë.

Gjonbaba ngriti flamurin e Marinës sonë Luftarake. Vuri mirë rrethet e litarëve në përrua dhe;

- Gati!

U gjendëm pranë anijes.

- Shokë! Pas kaq ditësh, çdo gjë e kemi në rregull! Tani ne do ta hedhim në ujë anijen tonë. Dhe me guxim do të sulmojmë hyrjen e Shpellës. Mund të kemi shumë vështirësi. Po ne, si bijtë e kapedanëve, do të hyjmë patjetër në Shpellë dhe do të zbulojnë gjurmët e lashtësisë sonë. Kështu do t' i sjellim një shërbim të madh historisë sonë. O burra, përpara! Ta bëjmë të pavdekshëm emrin e anijes sonë luftarake ***“Delfini i Pionierëve!”***

Gjaku na u nxeh. Dhe shpirti na u çua peshë. Me një frymë e shpumë fellukën në buzë të detit. Valët mezi lëkundeshin. Agimi po zbriste madhështor nga majat e Maleve të Vetëtimës.

“Delfini i Pionierëve” u fut në det. Dhe ne mbi të. Gjithsecili në vendin e tij. Dhe nisëm të vozisnim. Gjashtë rrema ngriheshin e kridheshin në ujë.

Ho-hopa! Ho-hopa! Ho-hopa!

“Delfini i Pionierëve” fluturonte. Dolëm në

det të hapur. Pamë fshatin tonë të bukur. Pamë shtëpitë e bardha, të ngjitura njëra me tjetrën... Ja dhe shtëpia jonë! Ja fiku! Ja dhe ullinjtë! Tani prindërit do të jenë zgjuar, mendonim, dhe do të kenë thënë: “Po ç’ u bënë fëmijët tanë? - Do të kenë shkuar në Stavridh për të parë vashat si kërcëjnë!” Ashtu do të kenë thënë. Dhe pastaj do të jenë nisur për në punë.

- Kthesë! Majtas! - thirri Gjonbaba, aty në përrua, në këmbë, si kapedan i vërtetë. Thika i varej në llërën e majtë. Në çengelët e brezit prej meshini i vareshin dy poçe elektriku, dylbitë, lëmshe spangoje, etj. Shikonte drejt Shpellës. Dhe ne të gjithë shikonim drejt Shpellës.

Dukej si një e çarë mali, që arrinte deri poshtë në det. Faqja e malit ishte si një pllakë e madhe shumëngjyrëshe ku mbizotëronte boja vjollcë dhe e kuqe...

Ho-hopa! Ho-hopa! Ho-hopa!

“Delfini i Pionierëve” shkiste si delfin i vërtetë. Dhe flamuri i Flotës sonë Luftarake ishte nderë shumë.

Kthesë! Pak djathtas... Ashtu! Tani drejt e në hyrjen e Shpellës!

Ho-hopa! Ho-hopa! Ho-hopa!

Të gjashtë rremat, nga dy secili nga ne të tre,
- përveç Gjonbabës dhe Lules që mbante

timonin, - ngriheshin e uleshin me shpejtësi të madhe.

“Delfini i Pionierëve” çante detin sikur të kishte motor aeroplani.

Tani që Shpella sapo vinte e bëhej më e madhe dhe më misterioze, lamë pas, shumë pas, çdo mendim... Sa larg na dukej tani Shpella e Al Evras, e cila nuk dukej më se e kaluam kepën e Shkëmbit të Kuq!

- Hopa! Hopa! Hopa!

Shpella na afrohej e na afrohej. Unë kujtoja, se me tu afruar, Gjonbaba do të urdhëronte të mbanim në erë rremat, për të parë mirë hyrjen, e pastaj të suleshim. Po jo! Ai ktheu kokën nga ne dhe hodhi një shikim, nga ku buronte guximi dhe shpresa, dhe thirri:

- Me të gjitha fuqitë, përpara! Hopa! Hopa!
Ho-hopa! Ho-hopa! Jepi! Jepi!

Ktheva sytë dhe pashë malin. Dukej sikur do të binte e do të na zinte!

- Timonin drejt! Mbaje fort! - bërtiti Gjonbaba. - Drejt! Fort! Drejt! Fort! Hopa! Hopa! Hopa! Drejt! Fort!

Hymë! Hymë në Shpellë! Shkasim ngjitur me të dyja anët e hyrjes së lartë.

- Rremat, lart rremat! I mbani si shtiza flamujsh!

Se hyrja ngushtohej e ngushtohej.

- Me duar! Me duar! - thirri Gjonbaba. Dhe nisi vretë të hapte duart e të shtyhej në të dyja anët e hyrjes së ngushtë.

Ne zgjatëm rremat mbi anët e anijes dhe nisëm të shtynim me duar, ashtu siç bëntë kapedani ynë. Dhjetë duar - pesë a. dej e pesë këtej, duke u shtyrë në hyrjen e ngushtë, - bënëin të shkiste anijën tonë, po jo me shpejtësinë e parë. Sa vinte e futeshim thellë.

Kur ktheva kokën pas për të parë Lulen, vura re se hyrja ishte zvogëluar. Tshim futur shumë thellë. Ende s' e kisha kthyer kokën, kur ndjeva se anija jonë diku u përplas dhe s' eci përpara.

- Një breshkë e madhe na ka zënë rrugën! - u dëgjua Gjonbaba.

E pashë që mori kamaqin dhe ia futi breshkës në kurriz, me sa fuqi kishte.

- Përpara, se breshka u zhyt!

Sa desha ta shikoja atë breshkë të madhe sa shkëmbi, që na pengoi rrugën!

- Mos u ndalni! Jepuni duarve! Sa të arrijmë pllakën që ndan kanalin nga deti i Shpellës! - bërtiste Gjonbaba, me një zë të fortë e të fuqishëm. Apo ishte vendi që e bënte ashtu zërin?

Me shumë mundime ecnim tani. Se nuk mund të shtynim më me duar pasi të dy anët e hyrjes ishin me uriqe deti shumë të mëdhenj. Nxinte vendi. Nxinte

dhe uji. Gjonbaba ndezi një fanar. Dhe e vari në një gozhdë të shtizës së flamurit.

U habita shumë me pamjen nën dritën e fanarit që tundej! Hiet e kokave tona zmadhoheshin e lëviznin. Më vinte keq për Lulen, se ishte në fund. Ajo duhet të ishte në mes. Ja, aty ku isha unë. Asnjë nga ... nuk fliste me zë. Po me vete nisëm të flisnim. Se nuk i thonë shaka! Të gjendesh në një brimë mali brenda në det! Ku shkonim kështu akoma? Po në qoftë se ato që na kish thënë Niko Daboja ishin krij ... të fantazisë, trillime? Si mund të ktheheshim prapa?

- Erdhëm! Ja pllaka! Ja pllaka!

Zëri ushtues i Gjonbabës më dha guxim.

- Urra! Urra! - thirri Fotoja.

Anija u ndal. I pari që u hodh në pllakë ishte kapedani ynë. Na ftoi të hidheshim të gjithë. Kur erdhi edhe Lulja, që ishte e fundit, Gjonbaba, me elektrikun e dorës, ndriçoi pllakën më tutje.

- Ta tërheqim anijen! - urdhëroi kapedani ynë.

Vetë ai hoqi litarin, e lidhi aty ku na kish thënë dhe pastaj të gjithë së bashku nisëm ta tërhiqnim. E prumë mbi shkallë, se kështu e kishim më lehtë ta shtynim.

Çudi! Sa qetësi e madhe! Asgjë s' pipëtinte. Në mes të pllakës u ndalëm pakëz. Feneri, mbi shtizën e flamurit, tundej. Dhe çdo gjë lëvizte, si në një botë

të çudirave. M' u duk se edhe ne lëviznim.

Lulja nuk më shqitej, më rrinte pranë.

- Ta shtyjme edhe pak! - urdhëroi kapedani ynë.

Me të arritur në buzë të pllakës, ndeshëm bregun e detit të shpellës.

- Erdhëm! Erdhëm! - thirri kapedani ynë. - Tani, dalngadalë, ta hedhim anijen në ujë...

Nuk u munduam shumë për ta hedhur. Secili nga ne hipi mbi anije dhe zuri vendin e tij.

- Të ndezim gjithë fenerët! - urdhëroi Gjonbaba.

I ndezëm. I varëm të gjashtë në gjashtë gozhdat e përgatitura në shtizën e flamurit.

Rremat në ujë! - urdhëroi Gjonbaba.

Sapo zgjatëm rremat dhe u bëmë gati për të vozitur, na u bë sikur dëgjuam një zë të fuqishëm, sa bubullima, e mua m' u bë sikur tha:

- Ndal! Ku shkoni?

Pastaj m' u duk sikur menjëherë të gjashtë fenerët u fikën!

3. Në detin e Shpellës

Zëri si bubullima dhe fikja e papritur e

fenerëve na tronditën. Asnjë nga ne nuk po fliste dhe u kapëm të gjithë njëri pas tjetrit.

Kur ç' të shohim! Nga fundi i detit mijëra prozhektorë lëvizës e bënë ditë shpellën.

- Janë sytë e peshqve të mëdhenj, - tha Gjonbaba.

Ndenjëm një copë herë ashtu. Deti i Shpellës dukej si në përralla. Mijëra ndryra të forta, si në ëndërr!

- Ngrini rremat! Gati për hundrim! - urdhëroi kapedani ynë.

Ndaal! Ku shkoni ashtu? - jehoi rapë ai zë i tmerrshëm dhe rrenqethës që patëm dëgjuar pak më parë.

- Jemi stërnipërit e Gjonbabës! - bërtiti kapedani ynë! - Nuk jemi piratë!

Menjëherë dritat e fenerëve u ndezën. Prozhektorët e syve të peshëve të mëdhenj u shuan.

Ne nuk po vozitnim më. Anija jonë qëndroi në mes të atij deti fantastik. Në çdo lëvizje që bënim, anija lëkundej. Edhe fenerët e ndezur tundeshin. Asnjë nuk fliste. Siç duket, gjuha na ish mbërthyer, siç na ish mbërthyer dhe sytë në pamjet e bukura mbi det, mbi ne, në të katër anët e Shpellës që dukej e pafund.

“Gllëk - Gllëk!” bënte uji pranë nesh! Dhe këto “gllëk - gllëk” shtoheshin. Gjonbaba që i pari që thirri:

- Ç' janë këto si kapuç të fryrë që i vijnë rrotull anijes sonë?

Vërtet, ç' ishin ata kapuçë të zinj e të fryrë që dilnin mbi ujë e pastaj kridheshin duke lëshuar atë zhurmë neveritëse "gllëk - gllëk!"

- Mos janë foka? - pyeti Jani.

- Po këtej, nga deti ynë, s' ka foka! - u përgjig Gjonbaba.

- Mos janë breshka?

- Mos janë gaforre?

- Mos janë kandile zeza?

- Mos janë sope?

- Mos janë gofe?

Nuk kishim parë kurrë peshq të tillë. As në ëndërr! Por kur Gjonbaba ynë e goditi një me fuqi në kurriz, ç' të shihnim! - Një gjullurdi si në skëterrë: lloj - lloj peshqish të shëmtuar nisën të kërcenin. Deti lëshonte shkumë të zezë, si katran. Tamam, ne gjendeshim si në një kazan katrani, që vlonte me furi. Disa peshq - shigjeta fluturonin mbi kokat tona.

- Gati thikat! - bërtiti Gjonbaba!

Sa do doja ta kisha më pranë Lulen! Më vinte shumë keq për të! Tani e kuptoja se sa shumë e doja! Dhe sa keq më vinte që disa herë isha sjellë keq me të!

- Lule! - thirra! - Eja më këtej! - Dhe, pasi

ajo nuk lëvizi nga vendi, lëviza unë. Po, me të lëvizur unë, anija u lëkund dhe peshqit e çuditshëm e shtuan vallen e tyre të skëterrës.

- Asnjë ndryshim në vendet! - Urdhëroi Gjonbaba. - Asnjë lëvizje! Rremat në duar. Uluni! Një! Dy! Tre! Përpara! Përpara sa të dalim në atë breg, atje... atje... - dhe tregoi nga e majta, ku binte drita e elektrikut të tij.

- Ho-hopa! Ho-hopa!

Anija jonë sikur bënte një vrapim me pengesa!
Dhe rremat tona takonin trupa të trashë peshqish në forma të ndryshme.

- Ho-hopa! Ho-hopa!

Mua më dukej sikur isha në ëndërr dhe sa dëshiroja të zgjohesha sa më parë!

Ho-hopa! Ho-hopa!

- Edhe pak, se arritëm! Tokë! Tokë! - bërtiti si i çmëndur nga gëzimi Gjonbaba ynë.

I pari u hodh ai! E mbajti fort anijen dhe na urdhëroi të zbrisnim. Pastaj, pa humbur kohë, e tërhoqëm anijen përjashta, në një plazh të zi me kum shumë të imët, më të imtë se sheqeri.

- Ta heqim më lart! - Urdhëroi kapedani ynë.

E tërhoqëm shumë lehtë, më lart. Shikuam nga të katër anët. Dëti, nga dolëm, nxinte. S' dukej gjëkundë fundi i Shpellës. Na dukej sikur ishim futur

në një tjetër botë të zezë.

Heshtrim!

Dhe deti i Shpellës që pak më parë vlonte nga një gjullurdi e çmëndur, tani sikur flinte i vdekur, pa frymë, pa gjë.

Dritat e ndezura, në direkun e flamurit, shpërmdanin një dritë, që nuk arrinte gjer në kufijtë e kësaj Shpelle fantastike.

Lulja m' u afrua.

- Ke frikë? - e pyeta.

- Jo! Po ti?

- Jo! Si të duket?

- S' kuptoj gjë! Po tani?

- Tani! - thirri Gjonbaba, - duhet të mos e humbasim, se jemi në zemrën e Shpellës, ku gjer më s' t nuk është futur njeri. Niko Daboja paska të drejtë... Gjer këtu, ashtu si thosh ai na doli... Pa të marrim nga e majta, mos hasim shtegun për në daljen e Shpellës.

Morëm secili fenerin e tij. Gjonbaba e la të ndezur në shtizën e flamurit, se ai kishte elektrikun e dorës.

Ai përpara dhe ne pas tij. As ndihej fare këmba jonë mbi atë kum të zi. Bënim ca hapa dhe ndaleshim. Sytë tanë s' linin skutë pa vëzhguar.

Sikur u dëgjua një zhurmë. Një britmë! Një ulërimë! Ulërimë e çjerrë! Si ajo e ujkut të uritur!

U ndalëm! Kthjem sytë pas. Feneri i varur në shtizën e flamurit mbi *“Delfinin e Pionierëve”* ndriçonte atje më tej. Jne deti i zi i Shpeilës, nën dritën e atij feneri, merrte ngjyra të papara gjer atëhere nga sytë tanë.

- Dëgjuat gjë? - pyeti Gjonbaba.

- Si ulërimë! - u përgjigj Jani.

- Ashtu... si ulërimë! Dhe ç’ ulërimë, pa... - përsëriti Fotoja, që rrinte i kërrusur e që i lëvizte sytë si ndonjë qen i trembur, i hedhur në ndonjë vend të rrezikshëm...

- Ç’ mund të jetë kjo ulërimë? - pyeti Lulja.

- A ulërijnë peshqit? - foli Fotoja.

- Peshqit fishkëllejnë!

Përsëri ulërima çjerrëse dhe shpuese na bëri të heshtim.

Pa dashur ishim grumbulluar dhe bërë një trup i vetëm me pesë kokë! Fotoja ishte në mes.

As unë nuk e di se pse, në këto çaste, m’ u kujtua shtëpia. Mu kujtua babai. Mu kujtua nëna. Manarët. Fiku. Niko Daboja. Mësuesi. Sa larg që ishin! Ishin apo më bëhej mua sikur ishin?

4. Viti 999!

Ecëm edhe ca. Sikur kishim rënë në një tjetër planet. Sikur nuk ishim në këtë botë! Unë nuk e di se

ç' vlonte në kokat e të tjerëve po në timen zienin mijra mendime të errëta, si bota e Shpellës së Piratëve

- Ç' është ajo atje?- pyeti Gjonbaba ynë. Dhe na tregoi me gisht, mu atje përpara nesh, një shtyllë guri vigane! Kthyem sytë andej. Shtylla ishte nja dhjetë metra e lartë dhe me tre metra diametër. Dukej sikur ajo e mbante malin, që ish çatia e Shpellës.

-Po ato shifra atje në mes?- foli Jani.

U afruam. Dhjetë sy panë tri shifra: **999**. U afruam edhe ca. Ngritëm fenerët dhe vumë re se çdo shifër **9** ishte, të paktën, dy metra e lartë.

Gjonbaba lexoi: "**VITI 999!**" dhe përsëriti me zë pyetës: **Viti 999?! Ç'është kjo datë?** Pa dale, të afrohem i të shikojmë me kujdes rreth shtyllës se mos ka shkrime të tjera.

Vura re se fytyra e Gjonbabës u çel dhe shprehte gëzimin e fitores.

-Shokë!- tha ai, - ja! Nisëm të zbulojmë gjurmët e historisë! Këtu paska pasur njerëz. Shtylla e tregon këtë... Kjo datë me, këto shifra të gdhendura kaq bukur, është dëshmia e gjallë e historisë..

- Kanë kaluar 964 vjet që kur është shkruar

kjo datë, - shtoi Jani.

- Nëndëqind e gjashtëdhjetë e katër vjet! - përsëriti me habi Fotoja, që bënte ç' bënte dhe sytë i zgurdullonte rreth e rrotull, sikur priste të shikonte ndonjë fantazmë, atë fantazmë që thirri "Ndal!"

I erdhëm rreth e përçark shtyllës vigane.

Nën si ifrat e mëdha 999 Lulja zbuloi edhe këto fjalë: "*Viti i Fitores!*"

Gjonbaba u afrua më pranë. Nxori një pecë dhe e fshiu më mirë vendin e shkronjave. Hodhi dritën e elektrikut të dorës, dhe ne lexuam me zë, të gjithë së bashku, si nxënësit e klasës së parë:

VITI I FITORES!

Një gëzир. i papërshekruar na pushtoi. Dhe harruam fare se ku ishim.

- Tani të ulemi e të hamë mëngjesin! - urdhëroi kapedani. - Se kushedi se ç' gjëra do të zbulojmë gjersa të hamë drekën. Sa e ke orën, Ilir?

- Ora është tetë e njëzet minuta! - u përgjigja unë, duke shikuar orën. (Se vetëm unë kisha orë).

Ualëm mbi kumin e zi. Fotoja na ndau nga një copë bukë e nga pak djathë, rrush e fiq.

Kapedani ynë hante duke parë shkronjat në shtyllë. Lulja përtypej ngadalë duke më parë mua.

Fotoja ende nuk e kishte kafshuar bukën që e mbante pranë buzëve. Ai shikonte me vetulla të rrudhura, dritën mbi shtizën e hamurit atje poshtë. Jani përtypej me nxitim.

Sikur s' na bënte zemra të ngriheshim më.

Dhe ia nisëm bisedës:

- Ç' do të jetë ky Viti i Fitores?

- Ndonjë fitore e Skënderbeut!

- Ç' thua ti ashtu? Skënderbeu atëhere s' kishte lerë. Ai lindi tre shekuj më vonë.

- Jo, he, po pesë shekuj më vonë!

- Në shekullin e dhjetë, ç' principatë ka qënë këtu?

- Mos ishte koha e Gjin Bue Shpatës?

- Jo. Ai erdhi më vonë.

- Atëherë ishte koha e Bizantit... Po edhe dyndja e barbarëve... e bullgarëve.

Biseda s' kishte të sosur. Na dukej vetja si banorë të kësaj bote. U mësuam me atë atmosferë. Tani edhe Fotoja e kish zgjatur kokën dhe kish nisur ta hante bukën. Dhe qeshte. Kushedi pse qeshte, kur flisnim ne për historinë.

- Pse qesh, Foto? - e pyeti Gjonbaba!

Fotoja nuk mund të përgjigjej menjëherë, se kishte gojën plot. Pasi gëlltiti ç' kish bluar me nxitim, tha:

- Qeshja me veten time... Të them të drejtën, u trondita shumë kur dëgjova atë zë që bubulloi, "Ndal". M' u bë sikur na përpiu errësira. Po ai zë do t' ishte me siguri oshëtima e zërave tona.

Lulja uli kokën dhe kafshoi dorën.

Edhe ne qeshëm. Gjonbaba u mendua dhe foli kështu:

- Të kesh frikë, s' del gjallë këtej!

U ngrit. Shikoi rreth e rrotull. U ngritëm edhe ne. Ai nisi të ecte. Edhe ne pas tij. Ai nxori thikën nga milli. Edhe ne i nxorëm thikat nga milli.

Nisëm të shkelnim në vend të fortë. Po i ngjiteshim një vendi si me shkallë. Arritëm në një shpellë të vogël. Në hyrje kishte shumë shtylla. Hymë brenda. Dyshemeja ishte me kalldrëm. Shpella dykej si një dhomë, se kishte kamare, potone, mindere guri dhe një shtrat.

Fenerët që mbanim në duar ngriheshin e uleshin, siç ngrihej dhe ulej vala e kureshtjes sonë për ato që shikonim.

Gjonbaba u mundua shumë sa e hapi atë kamare të gjatë si qivur. Ishte një kanavetë e bërë me një trung të prerë e të gdhendur bukur.

"Gëëëërrr! - bëri kapaku, kur u hap.

- Më ndihmoni! - u dëgjua zëri i Gjonbabës sonë.

Sa i rëndë që ishte kapaku! Si plumb.

Tetë duar e mbanin! Kurse duart e Gjonbabës preknin gjëra të çuditshme: Një shpatë, një mburojë, helmet,... dhe një libër të madh me fletë prej pa ħirusi të fortë...

Gjonbaba e mori këtë libër gjigand. Mezi e ngriti. Kur u largua pakëz, urdhëroi:

- Mbylleni!

Ne e mbyllëm kanavetën. Dhe iu afruam kapedanit tonë, që e kish shtrirë librin e madh mbi një poton.

Ai, gati sa s' fluturoi nga gëzimi. Hapi disa faqe dhe u kthye nga ne:

Është historia e Shpellës së Piratëve!

1. Emri i Rusman El Namsurit!

Kishim harruar sa ishte ora! Kishim harruar fare dhe ç' duhej të bënim para se të ngrysej! Ne kishim vendosur të dilnim para perëndimit të diellit, mirëpo nuk dirim ç' kohë ishte.

Unë që s' kisha besim te Fotoja, tani e shikoj ndryshe. Më dukej si një plak i mënçur. Sytë e tij dinak, tani, më ishin bërë të dashur. Kur filloi t' i dhimbte barku, unë kujtoja se barku e kishte zënë nga frika. Po ai i shkreti ish ftohur dhe megjithëse të prerat i kish kaq të forta sa e bënin të djersiste, prapsepapë duronte dhe na bënte për të qeshur. Tani ishte më mirë. Si të gjithë ne edhe ai shikonte librin e madh që kihte hapur Gjonbaba ynë.

- Me kujdes! - tha Fotoja, - Mos na bëhet shkrumb!

- Mirë e ka! - pohoi Gjonbaba. - Se me të vërtetë gati të bëhet hi është! Dhe kush e di ç' vlera ka... Po, pa dale të shohim, se mos nxjerrim ndonjë fjalë...

I pari, që zbuloi emrin e Rusman El Namsurit, ishte Fotoja.

- Ja, ja këtu si shkruan: Rusman El Namsur!
Të gjithë u ulëm dhe gati sa s' i ngjitëm sytë
në atë faqe të shkruar me dorë, po me shkronja latine
e me fjalë, që nuk i kuptonim dot!

- Po! - Bërtita unë - Rusman El Namsur!
Kryekapedani i piratëve që u vra nga Gjonbaba.

- Afrojini më shumë fenerët! E mos e prekni
librin! urdhëroi Gjonbaba ynë. - Dhe e ktheu librin,
duke nisur nga faqja e parë.

- Shkronjat janë pak a shumë si tonat, po me
të përdredhura...

“... U Gjon Nipi, biri i Gjonbirit et nipi i
zullumadhit kapedan Gjonbaba shkruoj istorian e ksaj
spelle, liruo ka fundi vitit 999 kontra saraceneve... Im
zot gysi Gjonbaba dëbou et mundi kursarin kapedan
pirat Rusman El Namsur”...

- Shumë mirë! Shumë mirë! - thirri i
entuziazmuar Jani. Qenka shkruar shqip... E kuptojmë
mirë!

- Po! Po! - thoshte, gati për të fluturuar nga
gëzimi Fotoja, - unë e kuptova, megjithëse është
shqipe e vjetër.

- Domethënë im atë e paskish dëgjur mirë që
Gjonbaba kish mundur Rusman El Namsurin!

- Po ku e dinte ai? - pyeti Fotoja

- Nga gojëdhanat! - u përgjigj Gjonbaba ynë.
- Se gojdhanat janë trashëguar brez pas brezi, shekuj e shekuj me radhë. Po tani kini durim, sa të nxjerrim këtë shkrim e këto fjalë të lashta...

- Domethënë, këto i shkruan Gjonipi! Po ç' është ky Gjonip ? - pyeti Lulja.

- Ja, tani do të shohim. Pa shih se sa faqe ka ky libër. Këtu, patjetër do të jetë edhe jeta e Gjonipit.

- ... Saraçenët mundoun tepër popullatën inë. Pushtoun spellën et sulmoun vatrat inë. Rrëmbyen et bijat et therën atët pleq. Piratë kusarë detit gjaksorë et mizëri ngritën fortesë kët spellë për nënt vjet... Nënt vjet giak et ziarr... Kapedani zullumadh Gionbaba rrethuo et zbuluo dalien e kësaj spelle et hyri brenda vetë et spërngulo kapedan pirat Rusman El Namsur.....

- Lexoje me ngadalë. Ç' thotë ashtu? - pyeta unë, i kredhur në ato që lexonte Gjonbaba ynë.

- Aman, mos e ndërpritni! - Uluriti Fotoja.

- ... et Rusman El Namsur ndezi beleg te përruo horës inë, kur si rrufe flakruo kapedan zullumadh Gionbaba et nië dit et dy net përlesje strou përdhe Rusman el Namsur, uku i deteve et ziarr i stereve... I preu kaptinën me zverk të rrumbullaktë sa të kaut et me miekër të giatë gjer te komba... Giaku rrodhi rrëke të përrou kië sot kiuhet Perrou Rusmanit...

- Kjo flet nuk lexohet dot!

- Me ngadalë, se mos grisit! Kur të dalim së këtejmi do të përpicemi ta lexojmë! - tha Fotoja.

- E kuptuat deri këtu? - pyeti Gjonbaba ynë.

- Unë jo! - tha Lulja, që ishte gjunjëzuar dhe mbante shumë pranë librit fenerin e saj.

- Si nuk kuptove? - u hodha unë. - Shumë e qartë: Gjonbaba nxorri nga shpella Rusman El Namsurin, e ndoqi dhe, pas një dite e dy net lufte, e shtroi përdhe dhe i preu kokën aty ku sot quhet Përroi i Rusmanit.

- Pse ç' do të thotë beleg? Ç' do të thotë hora? - pyeti Jani.

- Beleg do të thotë luftë! Hora do të thotë qytet! - u përgjegj i sigurtë Gjonbaba ynë, si një njeri që i di të gjitha. - Pa dale, se këtu nga njëra anë përkruan si ka qenë Gjonbaba dhe nga ana tjetër si paraqitej Rusman El Namsuri...

Ai lexoi e lexoi e pastaj u ngrit në këmbë e përsëriti:

"Gjonbaba, - shkruan Gjonipi, - ishte dy metra i gjatë. Peshonte sa një ka. Felluket zhyteshin në ujë, kur hipte ai në to. Një sy e kishte humbur në betejë kundër piratëve. Ne faqen e djathtë kishte shumë të çara thike: Syrin e humbur e mbante të lidhur me një pece të zezë. Mjekarën e kishte të dendur dhe

të gjerë deri te gjoksi i tij katror. Këmbët i kishte të shpejta. Mund të qëndronte edhe një javë pa ngrënë. Po kur hante, s'i dilte një dem i pjekur në hell. Verën e pinte si ujë dhe kurrë nuk dehej. Ditën që do të luftonte me Rusman El Namsurin, provoi forcat e tij duke ngritur në krahë një kalë të gjallë dhe duke shkukur një lis të moçëm... Kur kollitej, sikur bubullinte. Kur qeshte sikur shqyheshin çatitë e shtëpive. Kur zemërohej, sikur shfrynte tramundana e deti përplasej në grykat e shpellave të bregut tonë të ashpër. Kur hakmerrej, dukej më i nxirë se Malet e Vetëtimës kur shfryjnë tufanet e tërbuara...

“Nëntë vjet derisa shkuli piratët nga kjo Shpellë, që e kishin kthyer në kala të pamposhtur, jetoi si i tërbuar; nëntë vjet gjaku kish skuqur detin. Dhe felluket pa zot ishin përplasur nga dallgët në shkëmbinjtë e thepisur, si zemërimi i gjithë vendit. Se këta piratë të mallkuar kishin pushtuar edhe Siçilinë e Otranton dhe plaçkitnin çdo karavë dhe çdo anije që kalonte nga deti ynë, dhe bota kujtonte se ishim në p'ratët, që shkaktanim dëme, vdekje dhe turbullira...

“Këto ishin arsyet që e shtynë Gjonbabën në tërbim e në hakmarrje... Ishte duke mbaruar viti 999. Bota kujtonte se, duke gdhirë viti 1000, do të bëhej përmbytja.

“A durohet i huaji gjakësor në vatrën tënde?

Jo, kurrë! Andaj përmytja nuk do të jetë për botën mbarë, por për këta të paudhë... Ne do t'i çfarrosim...

- Ç' burrë! ë - e ndërpreu Fotoja.

- Ashtu kanë qenë të parët tanë! - ia ktheu Gjonbaba ynë. Po pa dale të shohim se ç' thotë për Rusman El Namsurin.

Ai lexonte, herë me zë, herë duke mëmëritur, herë duke lëvizur vetëm buzët. Dhe ne i bënim dritë, të heshtur, të mbërthyer, aty në atë libër, që mbante të shkruara gjithë ato gjëra të panjohura nga ne.

"Rusman El Namsur, - tregonte pastaj Gjonbaba ynë - ishte një ujk i detit. Kishte trupin e një gjarpri, se me gjarpërinj ishte rritur. Thonë se ushqehet me trutë e peshkut dhe se mund të zinte të gjallë edhe peshkaqenin; thonë se kafshët i vinte në gjumë me një shikim dhe delfinët i shkonin si manarë; thonë se kur këndonte ai, flinin erërat e detit... thonë se asnjë rrufe nuk e godiste... thonë se kur shfrynte deti nga furtuna, ai bëhej me qejf edhe lozë me shrëngatën, sikur loste me zogjtë e folesë.

- Ç' paska qenë ai! - tha Lulja me sy të zmadhuar.

- Ka qenë, po, - ja preu Fotoja, - por nuk e njihje ai Gjonbabën tonë... Nuk i njihje ai gjyshërit tanë, që ishin më të fortë se tramundana.

- Mos e ndërprisni Gjonbabën! - thashë unë,

se më pëlqente shumë të dëgjoja se ç' mbante ai libër i madh, me ato fletë të forta si lëkurë dhe me ato shkronja të qëndisura...

"... Lufta vazhdoi nëntë vjet, nëntë muaj, nëntë javë, nëntë ditë... Rusman El Namsuri nuk dukej! Dilte natën e kudo që shkelte nuk mbinte bari... Nuk e kapnin dot rrufetë e shigjetave... Nuk i dilte dot në duel Gjonbabës, që për nëntë vjet, nëntë muaj, nëntë javë e nëntë ditë rresht e kërkonte për t' i treguar vendin.

"Kryepirati nuk linte anije pa plaçkitur. Vendi ynë ishte shkëputur nga deti. Të tëra felluket tona ishin mbytur.

"... Rusman El Namsuri gajasej, hante, pinte, plaçkiste, vriste, digjte... Ndërsa Gjonbaba e ftonte të dilte në mejdan e të provonte forcën e tij... Kryepirati ishte dhelpër. E kish parë nga shpella Gjonbabën dhe e kish kuptuar se po të ndeshej me të, do të humbiste, do të vritej...

"... Në kohën kur bota priste kiametin, se për pak ditë do të agonte viti 1000, gjë që e priste dhe vetë gjarpri dhe ujku i detit, Rusman El Namsuri, ndodhi ajo që ndodhi: kryepirati duke u kapardisur doli me fellukë dhe sodiste malet tona... Gjonbaba, që për nëntë vjet, nëntë muaj, nëntë javë e nëntë ditë e ruante, dha urdhër që të bllokohej hyrja e Shpellës

dhe dalja në det të hapur. Dhe i doli përballë atij që i trembeshin edhe peshkaqenët e detit. Dhe i bërtiti: “Ku je, o frikacak! Ku je, o pjellë e errësirës dhe e ligësisë! Dil në fushë të mejdanit, o turp, o i lyer, o derr, o gjarpër, o hije...”

“... Rusman El Namsuri qeshi. Dhe kur qeshi ai, kërcyen peshkaqenët nga deti... Rusman El Namsuri u vrenjt dhe, kur u vrenjt ai qielli u nxi dhe deti filloi të nxirrte gjarpërinj! Rusman El Namsuri thirri i egërsuar, dhe kur thirri ai i egërsuar, dallgët u ngritën sa mali dhe malet oshëtinë.

“Pritmë, o qorr me një sy, pritmë, o buall i fryrë, ƒ ritmë, o i tmerruar, i frikësuar, i humbur... Tani, atë plëndësin tënd do ta bëj karrem për smirnet, për oktapodët...”

“... Dhe doli në stere. Dhe mori të përpjetën, por s' kishte bërë as dy hapa, kur Gjonbaba i bërtiti: “Mos e shkel këtë vend të pastër me ato këmbë të ndyra!” dhe i hodh si rrufe ..

Përleshja zgjati nëntë orë! Luftonin balozi i zi me zotin e vendit! Dhe kur binin të dy të mbërthyer, rrokulliseshin shkëmbinjtë. E po të binin në trungjet e lisave apo të ullinjve, trungjet thyheshin sikur të ishin kashtë misri.

Piratët saraçenë ulërinin si çakej të tërbuar për t' i dhënë zemër kapedanit të tyre, që dukej si një bishë e trullosur... Kur ish duke perënduar dielli,

Gjonbaba e sulmoi me tërbim, e shtriu përdhe, nxori këllëçin dhe i preu kokën...

- Urra! - thirri Fotoja...

... Gjaku shkoi rrëke... dhe ai vend u bë përrua i gjerë... Ishte gjaku i Rusman El Namsurit ai që e hapi atë përrua...

... Saraçenët, të tmerruar, ua hipën fellukeve të tyre dhe u zhdukën në horizontin e detit, që po errësohej.

... Zunë të binin daullet, këmborët, zilet... Fshati vallëzoi tërë natën rreth kokës së kryepiratit, të cilën Gjonbaba e kishte ngulur në një shtyllë, në mes të një lëmi.

Fitorja e vitit 999 i dha zemër popullatës, që e harroi fare lajmin e përhapur për përmytjen që do të bëhej duke u gdhirë viti 1000...

Viti 1000 gdhui mirë... Njerëzit, që pa zbardhur mirë, i thoshin njëri - tjetrit: "Mëngjesi i mirë!" "Mëngjesi i mirë!", "Mirëmëngjesi!"

Dhe kur erdhi dreka, dhe pasi panë që kiameti s' po vinte, filluan t' i thonë njëri - tjetrit: "Mirëdita! Mirëdita!"

Dhe kur po perëndonte dielli dhe kiameti s' po dukej gjëkund, njerëzit, të gëzuar, të lehtësuar e plot shpresa, i thoshin njëri - tjetrit: "Mirëmbrema!" "Mirëmbrema!"

Dhe kur u dëndësua muzgu dhe ra nata, dhe kiameti nuk po dukej gjëkund, njerëzit, të lumtur për fitoren e jetës dhe për fitoren kundër saraçenëve, nisën t' i thoshin njëri - tjetrit: "Natën e mirë! - Natën e mirë!"

... Kështu, që ditën e parë të vitit 1000 kur e pa bota se s' u bë përmytja sipas parashikimeve të profetëve, njerëzia nisën t' i thonë njëri - tjetrit: "Mirëmëngjesi! Mirë dita! Mirëmbrema! Natën e mirë!"

- Çudi! Ja, edhe këtë nuk e dinim! - tha Fotoja.

- Sa gjëra nuk dimë ne ende! - shtoi Jani.

- U lodhe! - i tha Lulja Gjonbabës. - A pushon pakëz?

- Mirë e ka Lulja! - shtoi Jani. - Tani duhet të hamë ndonjë gjë, se na mori uria.

Vendosëm ta ndërprisnim leximin. Gjonbaba ynë na hodhi një shikim për të parë se në ç' gjendje ishim.

- Kemi në dorë historinë tonë! - tha ai. - Ky libër do të çudisë gjithë botën. Ta ruajmë si sytë e ballit, sa ta nxjerrim nga Shpella e ta dërgojnë në Tiranë... Tani, Foto, na ndaj pjesët. Të hamë se, më duket, këtu bën shumë ftohtë...

2. Gjonbiri

Hëngrëm. Dhe, çudi e madhe, nuk flisnim. Të gjithë ishim ulur në minderin e gurtë. Fenerët ndriçonin librin e madh, atë libër që kishim gjetur në kanavetën e drunjtë. Ishim si të mpirë e si të dehur, nga ato që na lexonte Gjonbaba ynë. Jetonim kohërat e lashta.

Gjonbaba ynë na tha: “Unë besoj se ata që do ta lexojnë më vonë këtë libër, nuk do të ndiejnë atë që ndiemë ne tani në këtë Shpellë e mbi këtë minder ku ka fjetur Rusman El Namsuri... Po të jesh në një biblioteë, ose në shtëpinë tënde dhe të lexosh këto që po lexojmë ne tani, do të thuash: ama ç’ përrallë e çuditshme! Kurse ne nuk themi ashtu. Neve na duket vetja sikur të ishim trimat e Gjonbabës! Neve, na duket sikur shohim kokën e prerë të Rusman El Namsurit, sikur i dëgjojmë këmbanat e fitores që gjëmuan nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër vjet më parë...” Pastaj kapedani ynë na pyeti:

- Si thoni? Të vazhdojmë leximin, apo të vaz’ dojmë zbulimin e Shpellës?

- Të lexojmë!

- Të lexojmë!

- Të shohim se mos ka gjë për Shpellën! - tha

Fotoja.

- Atëherë ju më ndritni dhe me durim le të përpiqemi të lexojmë atë që lexohet... - u përgjigj Gjonbaba ynë.

Dhe u ngritëm. Dhe përsëri, si më parë, ne i bënim dritë e ai, duke mërmëritur, duke lëvizur buzët, kthente njërën pas tjetrës ato faqe të mëdha. Ndodhte që disa faqe nuk lexoheshin fare, se ishin të mykura, të prishura, të bëra si gjethet e thata të fikut.

Fytyra e kapedanit tonë herë çelej e herë errësohej. Kushedi se ç' lexonte! Po edhe ne çoku nxirrnim ndonjë fjalë.

Unë lexoja: "U Gionipi duo tëh thom ensëh istorian et t' im eti, Gionbirit, përse ata kje do tëh dhiavasin ose e ndiglojnë se saa i naltë et hi mujtunë et l i përmishëriershim ashtë im at..."

- Po, - tha Gjonbaba ynë, dhe u ngrit. Dhe nisi:

"Saraçenët nuk e harruan kokën e prerë të kapedanit të tyre që lanë në këto anë. Prandaj, pas ca kohe, ata u kthyen përsëri me forca shumë më të mëdha..."

"... Po para se të vdiste Gjonbaba la këto amanete: e para: trupin e tij ta hidhnin këtu në detin e Shpellës; e dyta: në Shpellë të ngrihej komanda e mbrojtjes dhe kurrë të mos lëshohej në duart e armikut. Ai përmend dhe Shpellën e fuqishme të Qikllopëve,

që është në majën e Kepit të Karaburunit, përballë Sazanit... Atje në atë Shpellë është kyçi i mbrojtjes së detit tonë, kurse kjo Shpellë, kjo këtu, është më e fuqishme, se brenja ka det, ka ujë, ka vendbanimi për shumë legjione; Shpella e Qiklopëve nuk ka det brenda, nuk ka ujë e nuk ka dalje, kurse kjo Shpellë, ka dalje shumë të mirë e të fshehtë...

- More! - tha Jani - paska edhe burim këtu brenda!

“... Saraçenët, pra, u kthven për t’ u ha marrë. Kishin si komandant Xhebel El Lebexhin. Sulmuan Shpellën, por im atë, Gjonbiri, i biri i Gjonbabës, që komandonte trimat e vendit, kish përgatitur një plan të mençur. Sapo saraçenët të afroreshin me felluket e tyre të shpejta deri te hyrja e Shpellës. Lart mbi shkëmb, kishte vendosur dhe fsheliu qindra luftëtarë. Me t’ u dhënë ai urdhërin, ata që lart nisën të lëshonin serë të ndezur.... Saraçenët nuk e prisnin këtë lloj arme! U përvëluan. U hodhën në det. U mbytën. Dhe shumë nga fellukat e tyre të bukura i zunë tanët dhe i futën brenda në Shpellë.

- Ama ç’ emër të çuditshëm paska pasur ai pirat saraçen, Xhebel El Lebexh! - u dëgjua zëri i Fotos, që dridhej nga të ftohtët.

Loloja na hodhi një sy të gjithëve dhe na pyeti nëse dëshironim të vazhdonte ende të lexonte dhe të

na tregonte. Dhe ne, kureshtarë përse shkruante Gjonbiri, e lutëm të mos e ndërpriste leximin. Dhe ndërsa ai mërrëriste, unë vija re, tutje, horizontin e errët të Shpejës, dhe çoku ma përshkonte zemrën një e dridhur irrike, sepse mendoja: Ç' do të ndodhte me ne që ishim futur në atë Shpellë? Edhe sa do të qëndronim në atë botë të errët? Po pastaj e mblihdja veten dhe krenohesha e gëzohesha që ndodhesha atje dhe që dëgjoja ato histori të lashta...

“...Ç’ paska qenë edhe ai Gjonbiri! - nisi të fliste kapedani ynë: - Luftëra të egra paska bërë kundër bullgarëve. Pa dëgjoni se ç’ shkruan: ... Tokat tona i pushtoi mbreti Boris i Bullgarisë. Ai u shkul me një mizëri taboresh, dhe doli në brigjet e detit tonë. Bojarët dhe Vojvodët e Bullgarisë donin ta quanin vendin tonë Kutmiçevicë... Një bojar, me emërin Dajan Kalojan Bujan, u takua me atin tim, Gjonbirin. Takimi u bë majë malit të lartë të Çipinit, atje ku uji buron i kristaltë dhe ku thëllëzat ia thonë mëngjeseve të argjenta. Dajan Kalojan Bujani u gostit me mish sorkadheje dhe me tru dreri. Piu verë Palortoje dhe shijoi bukëvalen e stanarëve të ushtrisë sonë. Dhe si hëngri e piu mirë e mirë, mori leje dhe tha:

- O kapedan i deteve! Cari im më urdhëroi të takohemi dhe të ju parashtroj mendimet e tij.

Urdhëro e fol, o bojar Dajan Kalojan Bujan!

Ne e kemi zakon t' i presim miqtë e t' i dëgjojmë me vesh e me mend. Dhe pasi t' i dëgjojmë mirë me vesh e me mend, u përgjigjemi me gjuhën e gjakut tonë!

- O kapedan i deteve, o bir i dëgjuar i Gjonbabës arbëresh! Cari kërkon nga ju që të mos i prekni ushtritë e tij që vijnë këtu për t' u ndihmuar kundër piratëve që sulmojnë nga deti.

- O bojar Dajan Kolojan Bujani! T' i thuash carit tënd, se nuk e ftoi njeri të vijë këtyre brigjeve. Ai le të qëndrojë atje në brigjet e Detit të Zi dhe të shikojë tokat e tij. Se këto brigje kanë zot. Këto brigje janë tonat dhe ne, siç e keni dëgjuar edhe ju, dimë t' i mbrojmë fare mirë. Ashtu na kanë mësuar të parët tanë. Dhe këtë amanet na e kanë lënë gjyshërit dhe baballarët tanë: të mos lëmë këmbë të huaji mbi truallin tonë...

- O kapedan i deteve, o Gjonbiri i dëgjuar! Mos e zemëro carin tonë, se po u zemërua cari ynë, lumi Tuna tërbohet dhe Malet e Ballkanit nxijnë! Pranoni ndihmën e tij kundër saraçenëve dhe kini për të parë se do të keni përfitim.

- O bojar Dajan Kalojan Bujani! i thoni carit tuaj se këtu nuk i thonë Kutmiçevicë! Këtu i thonë Arbëri. Prandaj të kthehet me të mirë andej nga ka ardhur dhe të mbledhë ushtarët e tij që s' lanë gjë më këmbë. S' e lejon kanuni ynë që të vijë tjetri këtu dhe

të dal zot i vendit tonë. Kjo gjë mund të bëhet vetëm kur ky vend të mos ketë më asnjë banor arbëreshë, domethënë atëherë kur të gjithë, fëmijë, plaka dhe pleq, të jenë vrarë për të mbrojtur vatrat e tyre. Më kuptoni?

Bojar Dajan Kalojan Bujani nisi pastaj kërcënimet: “Po nuk i pranuat porositë e carit, ai do të zemërohet dhe s’ ka për të lënë njeri të gjallë!...

- S’ ma lejon kanuni im që të ta pres atë gjuhë dhe t’ ua hedh korbave, o bojar i hazdisur! S’ ma lejon kanuni im që atë kokë të ta pres dhe tua hedh baldosave të pyllit të Çipinit! S’ ma lejon kanuni im që atë trup të ta bëj copë e thërrime dhe ta shpërndaj në erë e ta gëlltisnin menjëherë sorrat, se ky vend nuk do ta duronte dot... Shpormmu që këtej dhe i thuaj carit tënd, Borisit grabitqar, të kthehet nga ka ardhur se s’ del dot i gjallë së këtejmi...

Dhe bojar Dajan Kalojan Bujani qeshi. U ngrit. Ngjeshi mirë përkrenaren dhe foli:

- Dëgjo, o kapedan i deteve, o bir besnik dhe i tmerrshëm i të madhit Gjonbaba, që mundi Rusman El Namsurin, cari im më porositi t’ ju jap edhe një sihariq tjetër: ai ka vendosur t’ ju emërojë vojvodë të kësaj ane të Nikopojës...

Gjonbiri nuk e la të vazhdonte:

- Vojvodët cari juaj le t’ i emërojë në tokat e

†ij në Bullgari dhe jo në tokat e huaja... E dini ju se si i themi ne kësaj? “Të pushtoj shtëpinë tënde me forcë pa pastaj të lëshoj një dhomë me qira!”

Loloja qeshi me vete dhe shtoi: - Ç’ përgjigje, ë? Deshi ta emërojë vojvodë!

- Ç’ do me thënë vojvodë? - e pyeti Jani.

- Grada të larta ushtarake dhe qeveritare në popujt sllavë... Tani më lini të lexoj më poshtë e të shohim se ç’ bëri cari Boris, - dhe u kërrus më shumë mbi atë libër të madh. Dhe ne i bënim dritë me fenerët tonë.

Pas pakëz Loloja tregonte:

“... Cari Boris vdiq pa arritur ta shikonte këtë bregdet, se Gjonbiri e kish lajmëruar: “Po u duke këtej, s’ kthehesh më i gjallë në Bullgarinë tënde!”... Por edhe pas vdekjes së carit Boris, na u duk një tjetër bullgar me emrin Samuil. Ky Samuili u dynd nga veriu pasi nënshtrroi kapedan Gjon Vladimirin. Gjonbiri i çoi lajm edhe i tha: “Këtej mos u mat të vish se këtu i thonë Arbëri! Në daç eja po qe burrë. Veç dije edhe këtë: këtu mund të vijë vetëm ai që ka zemrën si malet tonë dhe gjakun si deti ynë! Në i paç ti këto, eja!”

- Sa i mençur ka qënë Gjonbiri! - e ndërpreu Fotoja.

- Sa i mençur, dhe trim! - shtoi Lulja.

“... Samuili vdiq nga inati. Dhe vendin e tij e

zuri Ivan Vladislavi. Ivani e pa që s' ia dilte dot me forcë dhe përdori mjete të buta dhe dhëlpërake për ta shtirë në dorë bregdetin tonë. Po nuk i shkuan. Atëherë u bashkua me bizantin... po bullgarët e vranë... Dhe luftën e vazhdoi vojvoda Ivaca. Po edhe ky u tërhoq me bisht në shalë... Dhe trimat tanë i ngritën këtë këngë:

*Boris, Samuil, Ivaca
Bojarë, Vojvodë dhe Carë
Jini minj, po gjeni vrima
Se do të ju hajë maca...*

Lulja u shkul së qeshuri. Qeshi dhe Jani. Qeshi dhe Fotoja. Dhe Shpella oshëtiti kaq shumë, sa u duk sikur dikush bërtiti. Jehona vazhdonte në guvat e thella të çatisë-shkëmb.

- Ç' është kjo? - pyeti i shqetësuar Fotoja.

- Rënkimet e bojarëve dhe vojvodëve! - e ngacmoi Gjonbaba ynë.

Pastaj oshëtima pushoi dhe po dëgjohej vetëm vajtimi prekës i një shpendi të errësirës: "**Kuuuu - krrrrrak - kiiiiii - ko! Kuuuu - krrrrrak - kiiiiii - ko!**"

U mblodhëm pranë e pranë sa u bëmë një trup i vetëm. Edhe fenerët gati se i bashkuam. "**Kuuuu**

- krrrrrak - kiiiiii - ko! Kuuuu - krrrrrak - kiiiiii - ko!” Shpendi i Shpellës e nxirrte këtë klithmë therëse me një ritëm të vazhdueshëm.

- Do të jetë mbreti i lakuriqëve të natës! - tha Gjonbaba ynë. - Andej vjen ky zë! Andej do të jetë edhe dalja e Shpellës.

Të gjithë shikuam në atë anë nga kishte drejtuar dorën Gjonbaba ynë. Dhe s’ pamë gjë përveç errësirës. Në ato çaste m’ia m’ u kujtua zbritja me litar në daljen e Shpellës. Dhe më zunë të dridhura, se kur isha i varur me litar, atje në errësirë, dëgjoja zhurmën e tmerrshme të mijëra lakuriqëve të natës dhe kisha mbyllur sytë nga frika, duke pritur me ankth që të më tërhiqnin shokët. Dyshoj se sikur të më kishin lënë atje edhe pak minuta, do të më kishte pushuar zemra...

Zëri i Lules, që i tha Gjonbabës sonë “Lexoje më poshtë librin” më sollti në vete. Gjonbaba ynë u kërrus përsëri mbi atë libër të madh, shfletoi me shumë kujdes ato faqe të mëdha, sa kanati i një dritareje, dhe nisi të lëvizte buzët.

- Gjonipi ka qënë njeri me shkollë. - mëmëriti Fotoja.

- Shëëët! - ja preu Jani, që ndiqte me kujdes shkrimin e çuditshëm.

Dhe pasi lexoi Gjonbaba ynë shumë faqe të

librit, herë duke qeshur me vetë, herë duke rrudhur vetullat dhe herë duke psherëtitur, filloi të na lexonte me zë të lartë:

“ Po ja që ky vënd i bukur na lakmohej nga barbarët e hordhëtë e huaja, që vinin nga çdo anë. S’ qe dhe s’ qe e mundi të kjo popullatë të jetonte e qetë, që këto brigje të shijonin me qetësi ngjyrat e çuditshme të agimeve dhe të perëndimeve të magjishme, megjithëse ne nuk i kemi bërë njeriut keq dhe gjer më sot nuk kemi shkelur asnjë vend, ndonëse nga trimëria s’ matet njeri me ne... Po atëhere, ç’ është kjo dyndje e vazhdueshme e piratëve, e bojarëve, e vojvodëve, e carëve, e princave nga lindja dhe nga perëndimi? Në këto kushte, ne kemi qenë të detyruar të lindim dhe të vdesim me armë në dorë, të bëhemi motër me vetëtimën dhe vëlla me tufarin, të bëhemi shokë të pandarë të vullkanit dhe fëfëfis me shqiponjat e maleve të Vetëtimës dhe të Çipinit. Në këto kushte sulmi të vazhdueshëm të të huajve ne nuk i numërojmë kokat që presim, ashtu siç nuk i numëron bujku kallinjtë e grurit kur i korr! Këtë det e kemi skuqur me gjak njeriu! Faji nuk është i yni! Faji është i atyre që çmendurve që duan me çdo kusht të bëhen zotër të këtij vendi. Po a do ta lejojmë ne një gjë të tillë? Jo, kurrë! Rrufeja e zemërimit tonë le të bjerë kurdoherë mbi kokën e atyre lakmimtarëve, që duan të na

skllavërojnë!..

“... ashtu e pësoi edhe normani i dëgjuar Guiskardi bashkë me të birin e tij, trimin Boemundi... Këta, me dy ushtri të mëdha - Boemundi nga stereja dhe Guiskardi nga deti - pasi pushtuan dhe shtruan me zjarr dhe gjak Jerikon, i dërguan një lajmëtar Gjonbirit duke i thënë: ‘Ne do të vijmë atje, te ai vend i bukur i Arbërit. ti mos guxo të na kundërshtosh, se do të të pjekim të gjallë. Kemi dëgjuar se ushtarët e tu janë trima dhe të pamëshirshëm me armikun, po dije se ne kemi shtruar mbretër dhe ushtri më të forta. Kur të vijmë aty, bëna gati ushqime për dhjetëmijë veta. Mblidh pemët e shijshme të bregdetit tënd, mblidh deshët më të majmë dhe furrat le të përgatisin kuleçë të dëgjuar të asaj krahine... Dhe Shpellën e famshme të Gjonbabës zbraze sa më parë, se aty ne do të vendosim komandën për t’u hedhur përtej nisive të Korfuzit... Mos të të gënjejë mëndja të kundërshtosh, se të qau gërmadha...’

· Si shumë paska kërkuar kapedani norman, Guiskardi... - tha Jani.

- Mos e ndërpre! Pastaj ç’ u bë? - e pyeti Fotoja.

Gjonbaba ynë vazhdoi të lexonte:

“... Im atë, Gjonbiri, mblodhi trimat dhe u lexoi këtë letër të kapedanëve normanë. Dhe pasi ata e

dëgjuan, e pyetën: “Ç’ mendon të bësh, o kapedani ynë?” B. soj se është e qartë, more shokë! Si thoni ju! Të bëjmë ashtu siç kërkon shkelësi, apo të vazhdojmë rrugën që na kanë lënë të parët tanë? Jemi apo nuk jemi bijtë e këtij vendi? Jam a s’ jam unë bir i Gjonbabës? “S’ do mend që ne jemi bijtë e këtij vendi dhe ti je biri i Gjonbabës,” i thanë trimat.

“... Kuvendi i burrave vendosi të dërgonte trimat: *Lekë Gjik Nuri, Theodor Gjo Dedaj dhe Jak Bilbil Bixhilin* me një letër në Jerikon, që është në fund të limanit të Vlorës. Dhe këta shkuan e vanë. Pas tri javësh e tri ditësh erdhi mandata: të tre trimat ishin vrarë me të pabesë nga kapedani norman Guiskardi. Atëhere Gjonbiri, im atë zemërak, u bë furtunë. Ndënji tri ditë pa fjetur. Pinte verë të vjetër dhe shikonte detin. Pastaj u ranë trumbetave dhe u mblodhën trimat. U mblodhën edhe felluket e shpejta. Dhe flota u nis për në Kep të Gjuhës, kurse këmbësoria u ngjit maleve të Llogarasë për t’ i rënë armikut nga prapa. Gratë dhe vashat u armatosën dhe bënë gati gurëhedhësit, bënë gati serën dhe shigjetat. Fëmijët dhe pleqtë u shkulën për në majën e Vetëtimës dhe të Çipinit...

“... Armiku e zbuloi lëvizjen e Gjonbirit, Prandaj e nisi flotën e t.ç; të madhe që kishte nënshtuar gjithë brigjet e Mesdheut. Nga Jerikoni u nis vetë

Guiskardi, kurse Boemundi nga ana e steresë. Koha ishte e mirë. Pemët ishin pjekur. Dielli i nxehtë bënte që të vdisnin nga etja të dyja ushtritë... Në kepën e Gjuhës, aty ku është Shpella e Qiklopëve, nisi beteja. Trimat tanë i ranë armikut në befasi andej nga s' e priste. Normanët nuk e prisnin këtë sulm të rrufeshëm. Nga maja e Kepit të Gjuhës dolën arbëreshët dhe me gurëdhësit filluan të godasin fellukat normane. Po në atë kohë fellukat tona u sulën dhe me burrëri i zinin felluket e normanëve dhe ushtarët e Guiskardit i hidhnin në det. Pas pak orësh beteja mori fund. Një pjesë e madhe e ushtarëve normanë mundi të shpëtonte. Ata dolën në stere dhe morën malet e luginat. Ngado që shkelnin nuk linin gjë në këmbë. Shkatërruan arat dhe pemët... Guiskardi shpëtoi për mrekulli dhe mori drejtimin e veriut dhe nuk është e vërtetë ajo që përhapën normanët, se gjoja u mbytën nga furtuna e detit. U mbytën nga furtuna jonë...

'... Ati im i dashur, trim Gjonbiri, u plagos rëndë në këtë luftë dhe pas nëntë muajsh, nëntë javësh dhe nëntë ditësh mbaroi rrugën e tij trimërore dhe lavdiplotë. Para se të jipte shpirt, më dorëzoi shpatën e tij dhe më porositi: "O biri im! Në gjakun tënd këndo historinë e fisit tënd! O biri im! Në shpirtin tënd ti ke shpirtin tim dhe shpirtin e të madhit Gjonbaba! Linde me nder dhe ngrype me nder! Dhe mësoju bijve të tu

dhe nipërve të tu mësimin e shenjtë të mbrojtjes së vatrave tona nga çdo shkelës, pirat ose barbar. Mallkimi rëntë mbi ty e mbi gjithë ata që do të pranojnë të marrin frymë duke pasur miqësi me armiqtë e popullit. Qoftë i mallkuar ai që do të jetojë duke lënë vendin të shkelet nga këmba e huaj!... Kur të hedhësh sytë nga malet tona, kujto se ato janë streha dhe kalaja jonë shekullore! Ato janë miku ynë besnik! Dhe kur të hedhësh sytë nga deti, kujto se në valët e tij janë shkrirë kokallat e gjyshit dhe babait tënd! Mbrojeni detin tonë dhe gjithnjë fytyrën e mbani drejt tij me krenari, se është deti ynë, është jeta jonë!...”

“... Unë nuk qava fare. Por kur pashë luftëtarët t’i binin gjoksit të tyre dhe të shkulinin flokët e gjata të kokës së tyre, ku pashë vashat të prisnin flokët dhe nënat t’i lëshonin flokët dhe të çirmin faqet duke vajtuar me ligje trimërie, m’u mbushën sytë me lot dhe e vajtova babain tim duke iu betuar se do ta vazhdoja rrugën e tij me besnikëri...”

“... Edhe trupin e babait e hodhëm në det, sipas porosisë që na la. Dhe trimat e tij më këshilluan të mos humbisnim kohë me vajtime dhe ligjërime, po të bëheshim gati për luftë, se piratët kishin filluar të dukeshin në veri dhe në jug...” Gjonbaba ynë vazhdoi të lexonte më tutje në librin e madh. Pas Gjonbirit ne mësuam për trimëritë e Gjonipit i cili, bashkë me popullin, kishte ndjekur rrugën e të parëve të tij.

PJESA E PESTË

1. Rruga e kthimit

Kishim harruar fare se jetonim në këtë shekull. Ishim bërë edhe ne si luftëtarët e shekullit të dhjetë dhe ishim kredhur në ato luftëra të pandërprera për mbrojtjen e brigjeve tona.

Ishim të gjithë të këputur, gati si nëpër gjumë. Madje ndonjëri nga ne edhe dreqiste! Këmbët na ishin mpirë. Kishim uri.

Na solli në vete Gjonbaba ynë, i cili e mbylli me kujdes librin dhe, duke rregulluar pajisjet e tij, mori drejtqendrimin e na dha këtë urdhër:

- Ti Ilir dhe ti Jani, merrni me shumë kujdes librin! Tani të gjithë përpara, Të shkojmë sa më shpejt te felluka jonë, te *“Delfini i Pionierëve”*. Me të mbërritur atje, do të ulemi të hamë.

Dhe pastaj nuk foli më njeri. Fenerët tanë tundeshin, kurse feneri i anijes sonë nuk lëvizte. Ai ndriçonte atje poshtë si ai fari që u trgont drejtimin anijeve furtunë.

“Sa mirë u mendua kapedani ynë që e la fenerin atje poshtë, mbi shtizën e flamurit të Marinës sonë luftarake! - mendoja unë. - Se po të mos e kishim lënë atje fenerin, nuk di si do ta gjenim anijen tonë”.

Tani që ishim në rrugën e kthimit, fillova të sillja ndër mend jetën nën diell, shtëpinë time, nënën, babanë, shokët. “Sa do të jetë ora? Sa orë kemi që jemi zhdukur nga familja, nga fshati? pa tjetër që do të na qortojnë. Dhe kanë shumë të drejtë. Nëna dhe babai do të jenë mërzitur shumë. Në këto raste babai hesht.

Unë e kuptoj kur ai mërzitet, prandaj dhe nis t’i flas dhe përpiqem ta bëj të qesh ngandonjëherë. Përpiqem ta lehtësoj. Po ai më hedh dorën në kokë dhe më thotë: “Ti, Ilir, mëso! Ndihamo motrën edhe nënën tënde. Merru edhe ti me punët e shtëpisë si në t’ë tjerët. Se kur unë isha në moshën tënde, bëja edhe kulaç. Bëja edhe gjellë. Dhe kur vinte nëna ime nga puna, shtëpinë e gjente në rregull, të pastër. Dhe sofrën të shtruar. Dhe ajo më puthte dhe më thoshte: “Të lumtë o bir i nënës!” Im atë nuk flet shumë por punon shumë. Më pëlqen kur e dëgjoj të flasë për trimëritë e të parëve tanë, për luftën partizane. Më pëlqen shumë, kur e shoh ashtu burrëror, të heshtur e kryelartë. Babai im! duhet të më falësh. Se patjetër kjo ekspedita jonë do të të ketë shqetësuar shumë. Po kur të dëgjosh se

ç' kemi parë dhe të shikosh këtë libër të historisë, do të na falësh... Dhe do të mburresh. Se biri yt dhe vajza jote qenë të parët që hynë në Shpellën e Piratëve...”

- U lodha! - u dëgjua zëri i Fotos. - Të ndalemi pakëz! Më merren këmbët. Më merren mëntë...

- Ja, se arritëm! - i përgjegy komandanti ynë.
- Dhe u kthye e i hodhi krahun Fotos. Por Fotoja u mundua të ecte pa ndihmën e kapedanit tonë.

Jani, i kapitur, e mbante librin sa në një dorë në tjtren, se ishte i rëndë dhe e lodhte shumë. Herë herë më hidhte ndonjë sy. Dhe unë e kuptoja se dhe ai me zor mbahej në këmbë.

- Do të çuditen të gjithë! - tha. - Do të mblidhet gjithë fshati.

- Pa le kur ta marrë edhe radioja!

- Edhe gazetat!

- Se s' i thonë shaka! Një libër i shkruar shqip njëmijë vjet më parë!...

- Nuk mundem më! - tha Fotoja, dhe u rrëzua.

Rrëzimi i Fotos na turbulloi. Ne, me kujdes e vendosëm përdhe librin dhe u afruam pranë Fotos, që e mbanin kapedani ynë edhe Lulja. E fërkuam. E përkëdhelëm. Ai i mbante sytë të mbyllur dhe përsëriste:

- S' kam gjë! S' kam gjë! Eh, se ç' do të vejë! Do të çuditen të gjithë... Pa le sa do të gëzohet

Niko Daboja, se ai na e tregoi hyrjen. - Pasi heshti pakëz, hapi sytë, na pa: - Unë nuk e kam shkelur betimin. As nënës simë nuk i kam treguar gjë...

- E, Foto si ë ndien veten? - e pyeti komandanti ynë.

Me mundime arritëm te anija jonë. Sa të bukura dukeshin shkronjat e bardha *“Delfini i Pionerëve”!*

Gjumi, lodhja dhe historitë fantastike të shekullit të dhjetë na kishin dërmuar. Mua gati po më mbylleshin sytë. Oh, sa dëshiroja të flija. Të shtrihesha aty, në kumin e zi e të flija... të flija... Dhe ja, i përgjumur, siç isha, u mbështeta te Jani. Edhe ai më duket se po flinte. Gërhiste lehtë. Fenerët i kishim të gjithë mbi anijen. Edhe librin e historisë e kishim vendosur me kujdes mbi pupë.

Mua më bëhej sikur isha i zhytur në kumin e zi dhe nuk dilja dot; më bëhej sikur më afroheshin dy gaforre të mëdha pa masë, me kthetrat e tyre gërshtë, sa një spirancë vapori... I kishin hapur kërcënues kthetrat gërshtë dhe më afroheshin. Bëja të ngrihesha të vrapoja, po nuk mundja. Më kish mbërthyer kumi i zi. Bëja të nxirra thikën e mprehtë, po duart më ishin mpirë... Dhe gaforret e tërbuara rrëshqisnin e më afroheshin... Dhe unë sikur isha fill’ i vetëm. Pa nieri. Thirra e thirra: Gjonbaba! Gjonbaba!”

- Ç' ke? Ç' të ngjau? - më pyeti i llahtarisur
Jani, që u hodh përpjetë.

I shtërngova dorën. U bëra një me të. Se edhe
unë brofa më këmbë.

- Gaforret! Gaforret! - thirra!

- Ku janë?

- Ja! Po vijnë... Po vijnë!

- Po ku janë? Nuk i shoh.

- Ja... ja...! - dhe drejtoja dorën nga errësira
e detit të zi.

Ai fërkonte sytë. Shkoi e mori fenerin. E vuri
më lart.

- Nuk shoh gjë!

- Ç' ka ngjarë? - pyeti Gjonbaba, i cili flinte.

Na u afrua, nxori thikën nga milli: - Ç' është? Pse nuk
flini?

- Gaforret! - murmurita unë.

Ai bëri ca hapa më tutje dhe kur hodhi dritën
e elektrikut nga ajo anë që shikonim ne, me të vërtetë
pa një grumbull gaforresh vigane që nuk lëviznin.

- Flenë! - tha.

U kthye nga ne. Ngriti duart si ata që duan të
shmpijnë trupin, mori drejtqëndrim dhe urdhëroi:

- O burra, të nisemi! Se po fjetëm më do të
mpihemi...

Zgjuam edhe Foton edhe Lulen. Motra ime

flinte ende, megjithëse ishte në këmbë:

- Ku jemi këtu, Ilir? më pyeti

- Në Shpellën e Piratëve!

- Uh! ç' ëndrra të bukura që shihja...

- Gati! - urdhëroi Gjonbaba ynë. - Shtyjeni anijen për në det.

- Po nga është deti? - pyeti Fotoja.

- Andej! - dhe bëri me dorë.

Ho-hopa! Ho-pa!

Shtynim. Dhe anija jonë shkiste mbi kumin e

zi.

Tani më dukej vetja më i lehtësuar, më i gëzuar, më i gjallë. Ktheheshim! Dhe si ktheheshim pa! Fitimtarë! Ishim të parët që hymë në këtë Shpellë të Piratëve. Dhe tani ktheheshim me **“Librin e Historisë!”** Eh, se ç' do të vejë!...

- Ho-hopa! Ho-hopa!

- Edhe pak! - përsëriste Gjonbaba ynë.

Zëri i tij kumbonte! Zëri i tij na jepte zemër e shpirt! Zëri i tij ishte kaq i dashur! Trim me fletë është kapedani ynë.

- Erdhëm! Nua! - thirri Gjonbaba ynë.

Na urdhëroi të siguronim më mirë **“Librin e Historisë!”** të mos harronim gjë, të mbanim thikat gati, të kontrollonim rremat, Lulja të provonte mirë timonin.

- Gati? - pyeti ai.

- Gati! - u përgjigjëm me një zë. E shtymë anijer. tonë *“Delfini i Pionierëve!”* gjersa ajo u gjend mbi ujin e zi. I fundit hipi Gjonbaba ynë. Shkoi në prua dhe ndenji në këmbë. Ne u ulëm, secili në vendin e vet.

- Gati? - pyeti përsëri ai.

- Gati! - u përgjigjëm ne me një zë.

- Përpara! Përpara me të gjitha forcat!

- Ho-hopa! Ho-hopa!

Dhe rremat uleshin dhe ngriheshin... Zemra na rrihte me gëzim se po ktheheshim nën diellin e ngrohtë. Kur... kur papandehur, nën anijën tonë u bë një përlëshje e tmerrshme... Dhe anija jonë *“Delfini i Pionierëve”* u kthye si një pendë e lehtë dhe u përmbys.

Të gjithë i ramë në det e bashkë me ne edhe libri, edhe plaçkat e tjera.

U zhytëm thellë në ujë por pas pak, si notarë të mirë, dolëm në sipërfaqe.

- Shokë! - u dëgjua zëri i komandantit tonë - mos u largoni, kapuni nga anija jonë e përmbysur.

Pas pak kohe pyeti përsëri.

- A jeni kapur të gjithë te anija?

- Si urdhëron! - u përgjegjën katër zëra!

- Mirë. Tani shtyni këtej nga vjen zëri im.

Dëgjuat? Shtyni!

- Si urdhëron! - u dëgjuan katër zëra.

- U biri me shumë fuqi këmbëve!

Ai për çdo çast jepte urdhra. Dhe ne i zbatonim duke shtyrë andej nga na vinte zëri i Gjonbabës. Detit dhe peshqve u binim me këmbë...

Isha shumë i gëzuar që asnjë nga ne nuk humbi në thellësitë e detit të zi.

Arritëm në tokë. Anijen tonë e nxorëm përjashta dhe e kthyem mbarë me shumë mundime. Pikonim ujë dhe nuk e dallonin dot shoshoqin ndonëse ishim pranë e pranë.

- Po tani?

- Tani! - u dëgjua zëri i Gjonbabës, - tani duhet të mendojmë se si do të dalim... Dhe pa tjetër do të dalim...

Heshti ca. Pastaj me një ton shpresëdhënës dhe guximdhënës shtoi:

- Më vjen keq që humbëm thesarin e çmuar të fitores sonë: Librin e Historisë së kësaj Shpelle. Po s' ka gjë! Ne uo t' i mbajmë mend ato që lexuam. Dhe do t' ua themi të gjithëve... Se, mendoj unë, ka një rëndësi të madhe historia e kësaj shpelle...

Mësimi më i madh historik i kësaj shpelle është ky: Piratët, ose çdo lloj shkelësi që të hyn në shtëpi, duhen luftuar me çdo kusht, gjer në asgjësimin e tyre, ashtu siç bënë Gjonbaba, Gjonbiri, Gjonipi dhe

stërgjyshërit, gjyshërit e prindët tanë.

Edhe më vonë, pas nëntëqind e ca vjetësh, sulmuan këtej fashistët italianë, që nuk kishin asnjë ndryshim nga piratët e shekullit të lashtë. Por prindërit tanë i pritën fashistët me pushkë dhe nuk i lanë të bëheshin zot të këtij vendi, por i luftuan gjersa i asgjësuan.

Unë habitesha nga këto që na thoshte kapedani ynë.

- Po tani? - u dëgjua përsëri zëri i Fotos.

- Ti që je i mënçur, ç' mendon të bëjmë tani?

- i tha Gjonbaba.

- E dini ç' mendoj unë?

- Ç'farë?

- Puna e parë që duhet të bëjmë është që të shtrydhim ç' kemi veshur, se po plevitosemi.

- Mirë e ke! - pranoi kapedani ynë. - Zhvishuni dhe i shtrydhni mirë teshat që kini veshur.

Asnjë nuk fliste. Secili po zbatonte urdhërin që doli nga mendimi i Fotos.

- Urdhëri u zbatua! - u dëgjua zëri i Janit. - Po tani?

- Ç' thua ti, Foto, - e pyeti përsëri Gjonbaba ynë.

- Unë mendoj të përpiqemi e të gjejmë ushqimet, që harruam të merrnim kur po ktheheshim...

E po i gjetën, të ulemi e të hamë. Se po hëngrëm, do të ngrihemi. Do benzinë motori ynë. Pastaj... pastaj... mendojmë e vëprojmë.

Me sa gjakftohtësi që fliste Fotoja. Ai Foto, që me e quanim frikacak! Unë nuk e shikoja dot Foton, por e përfytyroja me kokën të futur në jakë e me ata sytë e tij të zgjuar!

- Urdhëroj që, njëri pas tjetrit, të nisin të kërkojmë ushqimet. Fotoja ka të drejtë! - u dëgjua zëri i Gjonbabës.

Ecnim si symbyllazi. Po ku shkonim? Si do t' i gjenim ushqimet? Të paktën të kishim shpëtuar elektrikun e Gjonbabës. Shkrepset na ishin lagur dhe po t' i kishim, ç' do të ndiznim?

- Dritë! Dritë! - thirrri Lulja. - Ja, atje tej! Shikoni shikoni andej!

U ndalëm. Shikuam andej nga na thoshte Lulja. Me të vërtetë atje lart, mbi çatinë prej mali, hynte një dritë nga një e çarë. Drita ndriçonte zbehtë një pjesë të shpellës...

- Mund të ketë edhe të çara të tjera, sepse ndryshe si jetonin, muaj e vite me radhë, piratët dhe ushtarët e Gjonbabës?! - foli Fotoja.

E me të vërtetë, duke ecur më lart, pamë të çara të tjera, nga shumë anë të kubesë së pafund të Shpellës.

Ushqimet i gjetëm. U shqepëm së ngrëni.
Përtypeshim me nxitim, sikur t'ndiqte njeri nga prapa.

- Cilit nuk i hahet? - pyeti me djallëzi Fotoja.

- Ë, cilit nuk i hahet?

Asnjë nuk përgjigjej.

- Pse s; përgjigjeni? Siç duket, të gjithë hani me oreks të madh. Kjo është shenjë e mirë. Po sa do të jetë ora tani?

Unë ngrita dorën e majtë dhe afrova në vesh orën, po ajo nuk punonte. Kishte mbetur! “Edhe zemra e çeliktë e orës mbeti në ato çaste të vështira kurse zemrat tona rrihnin sikur të mos kishte ngjarë gjë!”

Heshtëm.

Heshtëm! Heshtëm si ata që janë plagosur rëndë dhe, pasi u ftohen plagët, ndiejnë dhimbje të forta.

Edhe ne ndjenim dhimbje të forta. Humbëm “*Librin e Historisë!*” me të cilin do të çuditej bota. Për të do të flisnin në radio, në shkolla, në konferenca. Po si ngjau? As që e mbaj mend fare! Vetëm më kujtohet një si tërmet i fuqishëm që na përmbysi sa të zije veshin me dorë.

Eh! Sa keq! Po... po sikur të ishim mbytur! Po sikur të ishte mbytur Lulja!... Po sikur të ishte mbytur Fotoja, Jani... Gjonbaba! Eh, Gjonbaba, nuk

mbytet kurrë se është kapedani ynë... Po tani? Tani si do të vejë halli ynë?...

Po të tjerët pse s' flisnin? Apo edhe ata, si unë, tani mendonin për faun tonë të zi! Si dreq ndodhi përmytja dhe s' na mbeti asnjë fener? As edhe elektriku i Gjonbabës! As edhe një litar! Asgjë! Asgjë! Po shyqyr që mbajtëm thikat! Se thikat na hyjnë shpesh në punë...

Pse? S' mund të bëjmë zjarr duke fërkuar ose çukitur në ndonjë gur stralli? Po me se do ta nderim? Po sikur të copëtojmë anijen tonë "*Delfini i Pionierëve*"! - mendoja unë.

- Më dëgjoni! - foli Gjonbaba.

Dhe ne u shkëputëm nga mendimet tona.

- Nuk duhet ta humbasim! Po e humbëm mbaruan!

Zëri i tij kumbonte:

- Duhet të kërkojmë në skutat e shumta të Shpellës. Kushedi se ç' do të gjejmë! Mund të gjejmë armë të vjetra. Mund të gjejmë ndonjë tjetër libër të lashtë. Mund të gjejmë vegla... Pa tjetër që mund të gjejmë edhe ndonjë dalje... Ose, më në fund, atë kanavetë e thyejmë dhe e bëjmë rrema... Dhe, pasi të gjejmë vjetërsira të tjera, nisemi... Kështu do të dalim nga kjo shpellë me gjëra të çuditshme.

U ngritëm dhe, njëri pas tjetrit, duke ndjekur

gjurmët e kapedanit tonë, zumë të zbulojmë skajet e shumta të kësaj bote të Shpellës.

U futëm në një si ngushticë. Mbi ne kishte të çara nga të cilat hynte më shumë drita. Na u mësuan sytë dhe po shquanim çdo gjë. Shikonim shkëmbinjtë e mëdhenj me forma fantastike. Shikonim shtyllat e mëdha të stalaktiteve. Gjetëm edhe burimin. Dëgjohej “çërr-çëëërr” uji që binte në një pellg, mbi një pllakë të pjerrët.

Ndenjëm rreth burimit. Uji dilte nga një tubguri.

- Këtu kanë pirë kapedanët e kohërave të lashta! - tha Fotoja.

2. Zbulime të tjera

Jo shumë larg burimit, që kishte një ujë shumë të ftohtë dhe ku e para piu Lulja, u ndalëm. Vendi ku qëndruam dukej se do të qe përdorur si banesë për shumë njerëz.

- Këtu do të ketë qënë ndonjë kazermë për ushtarë! - tha Gjonbaba ynë.

Duke ardhur rreth atij vendi, gjetëm disa ushta të gjata. Më tutje disa përkrenare hekuri, të

ndryshkura...

- Merrni të gjithë nga një ushtë! - urdhëroi komandanti ynë.

Edhe unë zgjodha një ushtë. Ishte nja dy metra e gjatë. Në majë ishte veshur me një metal shpues. Rëndonte, po unë e lëvizja nga të gjitha anët. "Kushedi se ç' duar e kanë përdorur! Kushedi se ç' beteja do të ketë bërë! Kushedi se sa piratë do të ketë shpuar!" Mendoja me vete.

- Zgjidhni edhe nga një përkrenare! - urdhëroi përsëri komandanti ynë.

Në atë grumbull përkrenaresh të hedhura mora një dhe e provova, po nuk më vinte pas kokës. Ishte shumë e madhe! Mora një tjetër, edhe një tjetër. Dhe më në fund gjeta një që ishte më e lehtë. E shkunda mirë ashtu siç bënë edhe të tjerët dhe me kujdes e vura në kokë.

Në këtë kohë hodha sytë nga shokët, po ç' të shihje! M' u dukën të gjithë njësoj: si kalorës mesjetarë! Nuk dalloja dot se kush ishte Fotoja dhe kush ishte motra ime!

- Gati për sulm jemi, shoku kapedan! - u shqua zëri i Fotos.

Lulja qeshi. Qeshi edhe vetë Gjombaba ynë, i cili tha:

- Më mirë të jemi të armatosur, se kush e di, shpella mund të ketë edhe bisha!

Fotoja u kollit me dinakëri. Pastaj shfaqti këtë mendim:

- Këto ushta mund t' i përdorim si rrema. E mira është që të mundohemi të kthehemi andej nga kemi ardhur, se po u futëm më thellë, s' kemi se si dalim më!

Gjonbaba, menjëherë, u përgjigj:

- Pa tjetër që do të kthehemi. Po meqë humbëm "Librin e Historisë" pa të mundohemi se mos gjejmë ndonjë thesar tjetër, që kur të dalim të kemi ç' tu tregojmë fshatarëve.

- Dëgjojmë mirë, shoku Gjonbaba! - tha prerë e qartë Fotoja. - Ne e kemi harruar se sa kohë kemi këtu brenda. Ne s' dimë se ku vemi, s' dimë se si do të dalim. Prandaj t' i vëmë gishtin kokës dhe të vendosim të dalim sa më parë.

- Dritë! Dritë tjetër! - bërtiti Lulja nga gëzimi.

- Ja... ja, atje lart!...

Një dritë tjetër, nga një e çarë e madhe, ndriçonte anën e majtë. Mbetëm gojëhapur nga format fantastike të shkëmbinjve dhe të stalaktiteve, nga ngjyrat vjollcë të errëta dhe nga fluturimi i disa shpendëve të çuditshëm!

- Këtej! - u dëgjua zëri i kapedanit tonë. Ai

përpara. Ne pas tij. Një e nga një. Me ushta të hedhura në sup, si ushtarët në parakalim.

Fotoja diç mëmëriti. Bënim ç' bënim dhe kthenim sytë nga burimi i çuditshëm i dritës. Nga hynte ajo dritë? Qielli nuk dukej fare! Mos ishte dalja, ku kishim zbritur me litar dikur... dikur... atëhere ... kur ishim mbi dhe?!

- Po ajo, ç' është ajo atje? - pyeti Gjonbaba ynë. Dhe u ndal duke parë përkundruall tij.

U afruam në një si kasollë guri, me një hyrje të ngushtë.

Kërkuam në kamaret. Jani gjeti një libër të trashë dhe thirri i gëzuar. Po me ta kapur me dorë u bë shkrumb e hi...

- Sa keq! Sa keq! - ulëriti Jani. - Kushedi se ç' histori të çuditshme do të kishte!

Më poshtë gjetëm grumbuj kafkash dhe kokallash, që lëshonin dritë e llamburitje...

Gjonbaba ynë mori një kafkë, që i kishte të gjithë dhëmbët!

- Folë, o stërgjyshi ynë! Ti re i ri! Dukesh nga që i ke gjithë dhëmbët! Kundër kujt luftove? A më dëgjon? Të flas unë, një nxënës i Republikës së Shqipërisë. Ti dhe shpirt këtu brenda në errësirë, se vendi yt atëhere ishte në luftëra me piratët... Tani ne jemi bërë zotër të vendit tonë. Ngreu dhe eja të vemi

bashkë e t' u flasësh njerëzve sot për luftërat e tua legjendare kundër piratëve për të mbrojtur nderin, lirinë dhe këtë tokë të shenjtë e krenare. Ngreu, o stërgjyshi ynë zulmëmadh, dhe shiko atje te përroi i Rusmanit, atje ku Gjonbaba mundi kryepiratin Rusman El Namsurin, se si jetojmë ne, të vegjël e të mëdhenj.

Po, o luftëtar i kohëve të lashta, edhe gjyshërit tanë, edhe prindërit tanë e ndoqën me besnikëri gjer në vdekje rrugën tuaj të heroizmave për liri kundër çdo pirati dhe tirani... Edhe ne jemi gati të biem si ti, o luftëtar legjendar, të biem në fushën e nderit, në qoftë se ndonjë pirat, i çdo ngjyre qoftë, do të guxojë ta shkelë Atdheun tonë të bukur...

Fotoja duartrokiti.

Gjonbaba atë kafkë nuk e hodhi te të tjerat, po e vuri në një çengel të brezit të vet.

Fjalët e tij sikur po na zgjonin e na binin në vete.

3. Kthimi

Ishim ulur pranë një djepi të hekurit. Djepit, në krye i vareshin disa thika. Ato ishin ndryshkur. Sa e pamë, provuam se mos e ngrinim, po ish e pamundur.

Ai rëndonte sa një tanks.

- Si tanks duket! - tha Fotoja! - Ç' djep është ky! Si e tundte gjyshja!

- Cila gjyshe? - pyeti Lulja.

- Po kush i tund djepet, nuk i tundin gjyshet?

- Pse, ka pasur gjyshe këtu? - pyeti përsëri Lulja.

- Pasi ka varreza, ka burim të ndërtuar, këtu do të ketë pasur jetë. Do të ketë pasur gjyshe e stërgjyshe, që mbylleshin këtu për t' u ndihmuar luftëtarëve...

Flisnim kot së koti! S' dinim se ç' thoshnim.

Vdiqëm për gjumë!

Mbërdhahnim!

I erdhëm shumë herë rrotull shpellës, po nuk e gjenim dot vendin ku kishim lënë "*Delfinin e Pionierëve!*" Kjo na mërziti shumë, aqë shumë sa nuk di si të them.

Gjonbaba po mendohej. Edhe Fotoja mendohej.

Të gjithë u lodhëm së menduari.

- Po nuk e gjetëm dot anijen tonë, duhet të provojmë se mos qëndron mbi ujë ajo kanaveta e gjatë sa një varkë! - tha me gjithë mend Fotoja!

- Je në vete? Po shkulet ajo nga vendi? - i tha Jani.

Në këtë kohë u dëgjua një batare e dëndur. Përsëri një batare tjetër. Heshtëm të gjithë dhe u çuam në këmbë.

Vendosëm më mirë përkrenaret, shtrënuam ushtat. Nga gjëmuan ato batare?

“Ta-tata-tatataa!” Pastaj një batare. Pastaj... ah pastaj... një dritë e fuqishme ngrihej andej poshtë. Drita lëvizte e lëvizte duke puthur çatinë prej mali të shpellës, duke puthur sipërfaqen e detit të Shpellës...

Ne u shtrënuam njëri pas tjetrit, me ushta të drejtuara andej nga vinte ajo dritë e madhe e fuqishme.

- He-he-heeee! Ku jëni?

Drita! Drita e vërtetë! Zëri i njeriut. I njeriut të vërtetë! Po pse jemi shtangur e s’ lëvizim dot?! Pse i mbajmë ushtat të drejtuara drejt atyre që vijnë duke thirrur si të çmendur nga gëzimi “I gjetëm! Janë gjallë... Lajmëroni se të pesë janë shëndoshë e mirë!”

Kur u afrua oficeri, me krahë hapur, Gjonbaba

 rriti:

- Drejtoni ushtat! Për nder armë!

Oficeri i marinës ndenji disa hapa përpara nesh, mori drejtqëndrim dhe na nderoi:

- Jam oficer i marinës sonë bregdetare. Kam marrë urdhër t’ ju kërkoj e t’ ju marr me vete.

Gjonbaba bëri një hap përpara.

- Jam kapedani i “Delfinit të Pionierëve!”

Gjithë anëtarët e ekspeditës janë fare mirë. Kemi zbuluar thellësitë e Shpellës së Piratëve. Po...

Nuk e mbaroi dot atë që kish për të thënë, se erdhën marinarët, na u turrën krahëhapur, na pushtuan, na puthën, na morën hopa... dhe ne qanim nga gëzimi, nga ai kujdes i papritur për ne, që endeshim pa shpresa në errësirën e Shpellës.

Drita e prozhektorit të fuqishëm e kish bërë ditë Shpellën. Dhe me të arritur në kumin, që më parë neve na dukej i zi, po që nuk ishte i zi, u ndalëm. Ne qëndronim mbi këmbët tona. Po, megjithatë, na dukej sikur fluturonim me krah.

Oficeri i marinës bregdetare i urdhëroi marinarët t' i afronin më pranë varkat e tyre. Dhe ata i afruan deri te buza e plazhit të shpellës.

- Shoku oficer, ne nuk mund të largohemi pa anijen tonë "*Delfini i Pionierëve*" - tha kapedani ynë.

Oficeri dha urdhër që menjëherë të hidhej në det "anija" jonë.

- Shoku oficer, ne do të lundrojmë me anijen tonë.

Dhe ashtu u vendos: Ne hipëm në anijen tonë, ashtu siç ishim: me përkrenaret dhe me ushtat e gjata në dorë...

Marinarët na shikonin sikur të kishim rënë nga

qielli. Po edhe ne i shihnin, sikur të kishin rënë nga qielli.

Me t' u futur në kanalin e ngushtë e me të arritur në pllakën e madhe që ndan detin e gjerë të Jonit nga deti i Shpellës, ne qëndruam ca, duke shikuar nga hyrja e Shpellës.

- Mirë u pafshim, o Shpellë e Piratëve! - tha Gjonbaba ynë. - Përsëri do të kthehem...

Kapërcyem anijen tonë dhe e hodhëm në kanalin e detit të gjerë.

Po pse na kishte ngecur gjuha në fyt? Pse ishim si të dehur? Pse nuk shikonim më njëri - tjetrin, po i mbanim sytë gjithnjë drejt daljes, nga hynte drita e pakufishme e qiellit tonë?

Ja! Mu në të hyrë të shpellës u duk një anije e rojave bregdetare.

Me të dalë nga hyrja "Delfini i Pionierëve", pamë marinarët e anijes që na përshëndesnin me flamuj të vegjël.

U ngritëm të pesë në këmbë Dhe u pamë nga dielli, u pamë nga qielli, u pamë nga qindra sy të marinarëve tanë.

Anija jonë po i afrohej anijes bregdetare.

- Ushtat lart! - urdhëroi Gjonbaba - Për nder armë!

Një "urra" e fortë shpërtheu nga marinarët.

Varka e oficerit u ngjit e u bë një me anijen tonë. Ne qëndronim më këmbë, të shastisur e të prekur. Nga e djathta ishin nja dy varka me fshatarë. Atje ishte edhe Niko Daboja. Të gjithë kishin ardhur për të na kërkuar.

-... Po... - thoshte oficeri i anijes bregdetare - Niko Daboja mendoi se ju do të ishit futur në Shpellë... Kemi gjithë pasditen që po mundohemi të futemi... Fshati është shqetësuar për ju... Tani lajmëruam se ju gjetëm...

- Do të ishim kthyer, po na u përmbys anija në luftë me peshqit e çuditshëm... - tregonte Gjonbaba.

- Tani, si mendoni ju, shoku komandant i anijes "Delfini i Pionierëve"?

- Ç' mendoj unë? Të dalim sa më parë në stere.

- Atë po bëjmë edhe ne, po... si thoni ju, nuk është më mirë që ju të hipni mbi anijen tonë... Të laheni, të visheni mirë... Se ja, atje... në Jaliskarë, ju pret fshati, ju presin prindët, ju presin shokët.

Jo! Ne do të lundrojmë gjer atje me anijen tonë të dashur! Mundësisht të na jepni gjastë rrema. Shumë mirë! - u përgjigj oficeri.

Dhe po të jetë e mundur, - shtoi Gjonbaba ynë, - anija jonë që kthehet nga beteja, të jetë në krye!

Shumë mirë! - u përgjigj përsëri oficeri duke

qeshur.

Lavdi *“Delfinit të Pionierëve!”* oshëtiti thirrja e fuqishme e marinarëve. Lulja buzëqeshi. Fotoja i kish zmadhuar sytë e tij të vegjël dhe përpiquej të mbahej krenar, kurse Jani shikonte andej nga varkat e fshatarëve.

Aty do të jetë Niko Daboja - më pyeti mua.

Po! - u përgjigj oficeri. - Ai është në varkën e tij. Na ndihmoi shumë për përgatitjen e hyrjes në Shpellë. Na prunë gjashtë rrema. Flamurin e anijes sonë e ndreqëm më mirë. Gjonbaba u ngrit në këmbë duke mbajtur ushtën e gjatë në dorë dhe përkrenaren e çuditshme në kokë. Kafkën e bardhë e kishte gjithnjë të varur në një çengel të brezit, dhe thikën, në llërën e majtë. Ai ktheu sytë nga ne dhe urdhëroi:

- Gati për kthimin! Rremat në erë!

Nisëm të vozitnim dhe në fillim ishim si të mpirë dhe shumë të lodhur.

Dolëm nga limani i vogël rrëzë shkëmbit si mal të Shpellës së Piratëve. Lulja timonin e mbante drejt Jaliskarit.

“Delfini i Pionierëve” ecte në krye; pas tij vinte varka e oficerit, më pas anija. Anash lundronin dy varka me fshatarë.

Në këto çaste më lindi një dëshirë e madhe që të isha te Shpella e Pano Gjinit dhe që andej ta

shikoja skuadrën e marinës sonë luftarake, me
“*Delfinin e Pionierëve*” në krye!

Ho-hopa! Ho-hopa! - thirri me të madhe edhe
Gjonbaba.

Dhe ne u dhamë me fuqi rremave. Dhe
“*Delfini i Pionierëve*” shkiste me të shpejtë mbi
detin e dashur që ish skuqur nga perëndimi i diellit.

Ho-hopa! Ho-hopa! Më shpejt! Më shpejt!
Kthesë më nga e majta, që të dalim pakëz më hapët!
Ho-hopa! Më shpejt! Më shpejt!

Marinarët mbi kuvertën e anijes këndonin.

Unë shikoja nga e djathta: Ja fshati ynë! Ja
Shpella e Panos Gjinit! Ja... ja... atje, pas atij rrapi të
madh, ishte shpëpia ime...

- Ho-hopa! Ho-hopa!

Ja dhe Malet e Vetëtirës! Oh, me ç’ ngjyra
fantastike i kish veshur perëndimi i diellit!

- Ho-hopa! Ho-hopa!

Ja dhe rruga e automobilit... Pa shih, pa shih!
Njerëz ishin ata atje, apo më bënëin sytë? Po! Njerëz
ishin... Mund të ishin pleqtë dhe plakat, që nuk kishin
zbritur dot gjer përposhtë në Jaliskarë...

Uji fëshfërinte në ballin e anijes sonë të shpejtë.
Flamuri ynë ishte drejtuar e bërë thikë!

- Ho-hopa! Më shpejt! Më shpejt!

Më dukej sikur fluturonin qiparisat e gjatë aty

në breg! Më dukej sikur fluturonte edhe dielli! “Po ndalu, o diell, ndalu edhe pakëz sa të arrijmë atje ku na presir...”

- Ho-hopa! Tani, timoni drejtë! Drejt! - përsëriste Gjonbaba ynë.

U lodhëm. Mezi lëvizja duart. Edhe pak. Edhe pak! Se ja, arritëm! Arritëm!

Po anija jonë po e huribiste shpejtësinë. Siç duket, edhe Fotoja edhe Jani, me t’ u afruar te kepi-skelë i Jaliskarit, e humbën si unë, dhe nuk kishin më fuqi të vozitnin.

- Ho-hopa! Ho-hopa! Tani? Tani i latë rremat? Tani që duhet të tregojmë forcën dhe guximin tonë? - thirri Gjonbaba duke na shikuar në sy. - Ju ftoj të mblidhni forcat e fundit! Përpara për parakalimin para prindërve dhe shokëve tanë! Ho-hopa.

Ngula mirë këmbët dhe u dhashë me tërbim rremave. “*Delfini i Pionierëve*” çau ujin e qetë dhe fluturoi përpara.

Një mori zërash të bashkuara oshëtinë!

Ktheji sytë andej! Ç’ të shoh! Moli ishte mbushur me kampistët, me shokët tanë, me prindërit... gjithë fshati kishte dalë.

- Urraaa! - buçitën zërat nga moli.

- Më këmbë! - urdhëroi kapedani ynë.

Dhe ne u ngritëm të gjithë më këmbë.

- Ushtat lart! Për nder armë!

Mua më dolën lotët. Dhe nuk dëgjoja më.
Shikoja se mos dalloja nënën dhe babanë. Po ku mund
t' i dalloja dot! Gjithë ata njerëz!

- Ushtat lart! Për nder armë!

Të gjithë qanin. Edhe Jani. Edhe Fotoja!

Lulja ish ngritur në këmbë. Si dukej me atë përkrenarë!
Tani e vura re mirë. Nuk ngjante fare me Lulen!

- Urdhëroj për herë të fundit! Për ndeeer
armë!

Kur ngritëm ushtat përpjetë, shpërtheu një
britmë e fuqishme me “urraaa!” e me “Rroftë *Delfini*
i Pionierëve!” “Urraaa!”

Anija jonë shkiste anash, përpara krahëve të
hapura, që na prisnin me padurim për të na pushtuar
me mall e me mburrje.

Anijet u afruan në breg. Përpara se të zbrisnim,
Gjonbaba ynë na përshpëriti:

- Nesër, ora 8 takimi te Shpella e Pano Gjinit.
Merrni me vete letër e lapsa. Duhet të shkruajmë
bashkë gjithë ato që pamë dhe sidomos ato faqe të
çuditshme që lexuam në librin e “Historisë së
Shpellës”.

FUND

Cip Katalogimi në botim BK Tiranë

Marko, Petro

Shpella e piratëve/ Petro Marko/ roman/ red. Vali
Xhixha. - Tiranë: Mësonjëtorja, 1998.

136 fq.; ...cm.

ISBN 99927-55-82-2

Tirazhi 3000 kopje

Formati 70x100/ 32

Shtypur në Shtypshkronjën "Mësonjëtorja"